

I. PËRMBAJTJA

I. PARATHËNIE	4
II. RESPEKTIMI I DETYRIMEVE QË RRJEDHIN NGA STRATEGJIA 1999-2002	5
II.1. Modeli institucional i Bankës së Shqipërisë.	5
II.2. Pavarësia e Bankës së Shqipërisë.	5
II.3. Plotësimi dhe përmirësimi i paketës ligjore dhe rregullatore.	6
II.4. Transparenca dhe ndërgjegjësimi i publikut.	6
II.5. Politika monetare, sistemi bankar dhe tregjet financiare.	7
II.5.1. Instrumentet e politikës monetare.	9
II.5.2. Tregjet.	9
II.5.3. Rezerva valutore dhe administrimi i saj.	10
II.6. Ngjarje të veçanta me të cilat u përball Banka e Shqipërisë.	11
II.6.1. Hyrja në qarkullim fizik e monedhës më të re: euro.	11
II.6.2. Tërheqja e depozitave nga sistemi bankar.	11
III. ZHVILLIMI I PËRGJITHSHËM I BANKËS SË SHQIPËRISË	13
III.1. Prioritetet e zhvillimit të Bankës së Shqipërisë.	13
III.2. Objektivi strategjik i Bankës së Shqipërisë-stabiliteti i çmimeve.	14
III.3. Regjimi i politikës monetare dhe i këmbimeve valutore, instrumentet për zbatimin e tyre.	17
III.3.1. Rezerva valutore.	19
III.3.2. Rezerva e detyrueshme dhe roli i huadhënësit të fundit.	19
III.4. Pavarësia, përgjegjshmëria, besueshmëria dhe transparenca e Bankës së Shqipërisë.	20
III.5. Edukimi i publikut dhe marrëdhëniet me të.	21
III.6. Reforma e sistemit financiar.	22
III.7. Integrimi në Bashkimin Europian.	25
IV. ZHVILLIMI I FUNKSIONEVE KRYESORE TË BANKËS SË SHQIPËRISË	26
IV.1. Mbikëqyrja bankare.	26
IV.1.1. Licencimi.	27
IV.1.2. Rregullimi bankar.	28
IV.1.3. Mbikëqyrja e jashtme.	28
IV.1.4. Inspektimet në vend-zemra e mbikëqyrjes bankare.	29
IV.2. Zhvillimi i statistikave.	30
IV.3. Emetimi i monedhës.	33
IV.4. Kontabiliteti.	34
IV.5. Sistemi i pagesave.	36
IV.5.1. Plotësimi i parimeve themelore për sistemin e pagesave.	37
IV.5.2. Përfundimi i sistemit RTGS.	39
IV.5.3. Sistemi i pagesave ndërbankare me vlerë të vogël.	39
IV.6. Zhvillimi i burimeve njerëzore.	40

PLANI I ZHVILLIMIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË, 2003-2005.

IV.6.1. Politika e nxitjes në punë të punonjësve.	40
IV.6.2. Politika e specializimeve në punë të punonjësve.	41
IV.6.3. Politika e punësimit.	41
IV.7. Organizimi strukturor i Bankës së Shqipërisë.	42
V. ZHVILLIMI I FUNKSIONEVE MBËSHTETËSE TË BANKËS SË SHQIPËRISË	44
V.1. Zhvillimi i teknologjisë së informacionit.	44
V.2. Funkzioni ligjor.	46
V.3. Mbrojtja e bankës.	47
V.4. Përmirësimi i kushteve të punës në bankë.	48
V.5. Forcimi i aftësive të kontrollit dhe të auditit të brendshëm.	48
VI. ÇËSHTJE TË TJERA	51
VI.1. Marrëdhëniet e Bankës së Shqipërisë me të tretët.	51
VI.2. Përfundim.	51

KAPITULLI I PARATHËNIE

Dokumenti "Plan zhvillimi institucional për periudhën afatmesme, 2003-2005" synon të japë një kuadër të plotë të drejtimeve të zhvillimit të Bankës së Shqipërisë në tre vitet e ardhshme. Ky dokument përshkruan hapat konkretë që do të ndërmerren për të siguruar përmbushjen e objektivave strategjike. Dokumenti synon të jetë një orientues i dobishëm për punonjësit e institucionit në periudhën afatmesme.

Banka e Shqipërisë është banka qendrore e Republikës së Shqipërisë. Veprimtaria e saj zhvillohet në zbatim të nenit 161 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 ndryshuar me amendamentin datë 29.07.1998 (ligji 8384) si dhe me amendamentin datë 25.07.2002 (ligji 8893).

Përmbushja në praktikë e detyrave që i jep ligji si dhe arritja e objektivave kërkon që Banka e Shqipërisë të ketë organizim, administrim e drejtim të përshtatshëm dhe efikas; kërkon që Banka e Shqipërisë të përmirësohet vazhdimisht; kërkon që Banka e Shqipërisë të miratojë politika e të marrë vendime të drejta dhe optimale; kërkon që Banka e Shqipërisë të jetë largpamëse. Këto kërkesa bëjnë të domosdoshme që zhvillimi i Bankës së Shqipërisë si institucion të konceptohet përtej një plani pune njëvjeçar. Këto kërkesa shtruan nevojën e hartimit të planeve afatmesme për zhvillimin institucional të Bankës së Shqipërisë¹. Në këto plane afatmesme (trevjeçare) përcaktohen objektivat më të rëndësishëm për të përmbushur gjatë periudhës, instrumentet kryesore që do të ndihmojnë në arritjen e tyre si dhe vendosen bazat për një sërë objektivash më afatgjatë, arritja e të cilëve kërkon hartimin dhe zbatimin e disa planeve të tilla.

Karakteristikë e këtyre planeve afatmesme është se formojnë një bosht rreth të cilit përpunohen në mënyrë më të detajuar planet afatshkurtra të çdo njësie në Bankën e Shqipërisë. Plani afatmesëm i zhvillimit siguron një harmonizim të të gjithë aktivitetit të institucionit. Gjithashtu, plani është fleksibël, gjë që lejon ndërhyrjen në rast shfaqjesh të nevojave urgjente apo edhe në rast dështimi në arritjen e një apo të disa objektivave.

Strategjia e Bankës së Shqipërisë në dekadën e dytë është ajo e një institucioni që bën përpjekje për t'u përafruar me bankat qendrore më të zhvilluara institucionalisht me qëllim final afatgjatë integrimin në sistemin monetar europian.

¹ Për herë të parë ky plan është miratuar me vendimin nr. 111, datë 17.11.1999 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

KAPITULLI II RESPEKTIMI I DETYRIMEVE QË RRJEDHIN NGA STRATEGJIA 1999-2002.

II.1. Modeli institucional i Bankës së Shqipërisë.

Plani i zhvillimit institucional i Bankës së Shqipërisë për periudhën 1999-2002 në vetvete ishte një plan ambicioz duke përcaktuar Bankën Qendrore Europiane si model institucional. Ky objektiv ambicioz u zbatua në kushtet kur integrimi i Shqipërisë në BE përfaqësonte një proces të gjatë dhe që BQE ishte një bankë në krijim e sipër, përfaqësuese e një rajoni shtetesh, jo e një shteti të vetëm. Për këtë arsye u hodhën hapa të kujdesshëm dhe jo të përshpejtuar duke synuar të adoptoheshin ato praktika të BQE, të cilat përshtateshin me realitetin shqiptar.

II.2 Pavarësia e Bankës së Shqipërisë.

Periudha e viteve 1999-2002 konfirmoi dy çështje: rëndësinë e pavarësisë për bankën qendrore dhe mbështetjen e brishtë që ka pavarësia e bankës qendrore në Shqipëri nga mjedisi i jashtëm.

Bazuar në rëndësinë që ka pavarësia për institucionin e bankës qendrore, Banka e Shqipërisë e identifikoi si objektiv të strategjisë së përgjithshme. Konkluzioni kryesor² nga studimet ishte se ***Banka e Shqipërisë gëzon një pavarësi të gjerë ligjore por nuk gëzon pavarësi të mjaftueshme në realitet.***

Këto përcaktime ndihmuan në detajimin e kuadrit të masave për të forcuar pavarësinë, duke e përqendruar vëmendjen në forcimin e pavarësisë reale. Për këtë u përcaktuan dy rrugë kryesore: realizimi i objektivit kryesor dhe ndërgjegjësimi i publikut. Në tërësi, banka qendrore arriti të përmbushë objektivat e përcaktuar në ligj dhe, në mënyrë më specifike, objektivin e inflacionit. Kjo situatë ndihmoi që banka qendrore të krijonte një profil të vetin institucional që karakterizohej nga: transparencja, besueshmëria, kthimi në institucion referencë dhe konsistenca në kohë për veprimet dhe deklaratimet e saj.

Ndërgjegjësimi i publikut i shërbeu për të bërë të njohur institucionin e bankës qendrore në publik (media; rrethe politike; rrethe akademike e profesioniste dhe popullsinë në tërësi) dhe tërheqjen e vëmendjes së tyre drejt aktivitetit të bankës qendrore.

² Shih "Elementet e pavarësisë së një banke qendrore. Banka e Shqipërisë sa e pavarur është ajo?", Shkëlqim Cani, Teuta Baleta, botim i Bankës së Shqipërisë, shtator 1999.

II.3 Plotësimi dhe përmirësimi i paketës ligjore dhe rregullatore.

Procesi i përmirësimit të kuadrit ligjor e rregullator ka synuar në qartësimin e klauzolave dhe në përafrimin e mëtejshëm me standardet ndërkombëtare. Konkretisht, është punuar dhe janë miratuar ligji “Për parandalimin e pastrimit të parave”, ligji “Për sigurimin e depozitave”, amendamente të ligjit “Për Bankën e Shqipërisë”. Në bazën rregullatore më të rëndësishme paraqiten udhëzimet e hartuara për herë të parë “Për kujdestarinë dhe likuiditetin”, “Për parandalimin e pastrimit të parave”, “Për çertifikatat e depozitave”, “Për ekspertët kontabël të autorizuar”, rregullorja “Për licencimin e shoqërive të kursim-kreditit dhe të unioneve të tyre” etj.. Gjithashtu, janë miratuar edhe disa rregullore për instrumentet e reja të politikës monetare si rregullorja “Mbi kredinë njëditore”, “Mbi depozitën njëditore”, “Mbi marrëveshjet e riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes” etj..

II.4 Transparenca dhe ndërgjegjësimi i publikut.

Rritja e transparencës dhe ndërgjegjësimi i publikut u konsideruan si aspekte kyçe për forcimin e pavarësisë së bankës qendrore; për rritjen e përgjegjshmërisë së saj institucionale dhe për rritjen e efikasitetit të politikës monetare.

Në këto aspekte mund të thuhet se periudha e viteve 1999-2002 ka manifestuar një hop cilësor të Bankës së Shqipërisë. Hapi i parë i rëndësishëm drejt transparencës ishte pranimi dhe deklarimi publik i vlerësimit të FMN-së në lidhje me qartësimin e rolit të saj, të përgjegjësisë që ka dhe të objektivave që duhet të përmbushë, Banka e Shqipërisë, përgjithësisht, i zbaton standardet e Kodit. Ndërsa, në lidhje me procesin e formulimit dhe të raportimit të politikës monetare, Banka e Shqipërisë i zbaton vetëm pjesërisht këto standarde³.

Si zhvillime më të spikatura mund të përmenden rritja e numrit të titujve të botimit dhe të faqeve të botuara. Informacioni që Banka e Shqipërisë prezantoi në publik ishte i shumëllojshëm dhe i gjerë duke filluar nga shtimi i të dhënave statistikore e deri tek analizat e studimet. Kjo e shndërroi Bankën e Shqipërisë në një burim të rëndësishëm informacioni brenda dhe jashtë vendit dhe në një institucion reference. Në funksion të komunikimit me publikun u ndërtua faqja e internetit me një strukturë të gjerë rubrikash.

Hap tjetër i rëndësishëm ishte miratimi i rregullores mbi “Transparencën dhe konfidencialitetin”, në qershor të vitit 2000. Në bazë të kësaj rregulloreje u vendos që në themel qëndron veprimtaria transparente e Bankës së Shqipërisë. Rregullat për ruajtjen e sekretit do të përdoren në raste të kufizuara në zbatim të legjislacionit në

³ Vlerësim i FMN në lidhje me respektimin nga ana e Bankës së Shqipërisë të Kodit të Praktikave më të Mira për Transparencën në Politikën Monetare dhe Financiare, “Raporti Vjetor 2000”, Banka e Shqipërisë.

fuqi. Përveç kësaj, u përcaktuan dhe detyrime konkrete në drejtim të rritjes së transparencës.

II.5 Politika monetare, sistemi bankar dhe tregjet financiare.

Marrëveshja ESAF-2 (e cila u shndërrua në marrëveshjen PRGF) e nënshkruar me FMN përcaktoi një sërë objektivash që vendosnin kuadrin brenda të cilit duhej të zhvillohej ekonomia shqiptare. Në tërësi, është vlerësuar se u përmbushën objektivat e kësaj marrëveshjeje ku kontribut ka edhe Banka e Shqipërisë. I padiskutueshëm është kontributi i saj në hartimin e një politike monetare realiste në harmoni me politikat e tjera ekonomike, sidomos me atë fiskale. Për më tepër, Banka e Shqipërisë u kujdes që të rriste efikasitetin e politikës monetare dhe të përmirësonte procesin e zbatimit të saj duke rishikuar dhe përpunuar instrumentet monetare.

Në tërësi, ekonomia shqiptare për periudhën 1999-2002 u karakterizua nga një rritje e shpejtë ekonomike; inflacion i ulët që mesatarisht u luhat në intervalin 0-3 për qind; reduktim i deficitit buxhetor; financim i deficitit buxhetor në nivele pothuaj të njëjta nga burime të jashtme dhe të brendshme; reduktim i vazhdueshëm i papunësisë; qëndrueshmëri e monedhës së vendit kundrejt dy monedhave të huaja kryesore për tregun shqiptar: dollarin amerikan dhe euron; rritje e të ardhurave për frymë; deficit i qëndrueshëm i llogarisë korente. Konkluzioni kryesor është se ekonomia shqiptare arriti, në përgjithësi, të rivendosë ekuilibrat pas trazirave të vitit 1997. Sfida kryesore qëndron në konsolidimin e tyre dhe në zhvillimin e reformave për të siguruar rritjen afatgjatë dhe reduktimin e varfërisë.

Për periudhën 1999 - 2002 inflacioni qëndroi në nivele të ulëta përkatësisht -1.0, 4.2, 3.5 dhe 2.1 për qind në fund të vitit duke u reduktuar nga 42.1 dhe 8.7 për qind që ishte në vitet 1997 dhe 1998. Kjo do të thotë që u arrit të sigurohej përmbushja e objektivit afatmesëm sasior për të mbajtur inflacionin në nivele të ulëta pozitive. Sfida përballë Bankës së Shqipërisë qëndronte në ruajtjen e stabilitetit të arritur të çmimeve, sidomos në kushtet kur vendi u përfshi nga një program privatizimi i sektorëve strategjikë; u përball me një sërë tronditjesh politike të brendshme dhe të jashtme si dhe u përfshi nga kriza energjitike, pa lënë mënjanë edhe faktorë të tjerë.

Kjo periudhë u karakterizua nga zhvillimi dhe zgjerimi i aktivitetit bankar. U shtua numri i bankave nga 10 në 14; u zgjerua aktiviteti me 9.3 për qind mesatarisht në vit (rritje reale); depozitat në sistemin bankar u rritën mesatarisht me 28.2 për qind në vit; u përshpejtua kreditimi i ekonomisë, teprica e kredisë nga 18.5 miliardë lekë në fund të vitit 1999 arriti në 37.2 miliardë lekë në fund të muajit nëntor të vitit 2002. Kredia e re e akorduar u rrit nga 8 miliardë lekë në 54.4 miliardë lekë për të njëjtën periudhë. Megjithatë, kreditimi i ekonomisë vazhdon të mbetet në nivele të ulëta. Njëkohësisht u përmirësua rezultati financiar i bankave, kreditë e këqija u reduktuan në 6.9 për qind ndaj totalit të kredive; u privatizua Banka Kombëtare Tregtare, banka e dytë më e madhe në vend, dhe u ndërmorën hapa për privatizimin e Bankës së Kursimeve. Niveli i kapitalit të huaj në sistemin bankar u rrit vazhdimisht nga 63.6 për qind në 95.2 për qind (shtator 2002). Përballë kësaj situatë Banka e Shqipërisë reagoi me

forcim të kuadrit mbikëqyrës dhe plotësim të mëtejshëm të paketës ligjore e rregullative.

Situata në sistemin bankar është rrjedhojë e zbatimit të reformës e cila u përqendrua kryesisht në privatizimin e dy bankave shtetërore dhe njëkohësisht bankat më të mëdha të sistemit bankar shqiptar: Bankës së Kursimeve dhe Bankës Kombëtare Tregtare. Privatizimi i bankave shtetërore ishte njëra nga shtyllat kryesore të reformës. Ky proces pati në vëmendje dhe përmirësimin e disiplinës në tregun financiar dhe të transparencës nëpërmjet krijimit të institucioneve financiare si Agjencia e Trajtimit të Kredive apo Agjencia e Sigurimit të Depozitave; rishikimit, plotësimin dhe forcimit të bazës ligjore e rregullative; rritjen e pavarësisë së bankës qendrore si dhe forcimin e aftësive të mbikëqyrjes bankare.

Megjithatë, në këto vite, përveç një rritjeje të aktivitetit të sistemit bankar dhe zgjerimit të tij edhe jashtë kryeqytetit, nuk u arrit dot të përmbushen plotësisht aspektet më kryesore të reformës. Banka e Kursimeve nuk u privatizua, jo për mungesë vullneti, por për krijimin e një sërë rrethanash të brendshme dhe të jashtme, që nuk e ndihmuan procesin e privatizimit. Banka Kombëtare Tregtare, megjithëse u privatizua, nuk arriti të jetë një ndër lojtarët kryesore në tregun bankar edhe për shkak të problemeve me pronarin e saj të ri. Agjencia e Trajtimit të Kredive nuk mundi të përmbushë funksionin për të cilin u krijua duke u kthyer në një tjetër precedent të dëmshëm për disiplinën financiare në treg. Zyra e Regjistrimit të Kredive ishte një tjetër projekt i mbetur i përealizuar. Së fundi, në tre vitet e kaluara, sistemi financiar, sidomos Banka e Kursimeve, u vunë nën presionin edhe të acarimeve politike, duke krijuar probleme.

Bazuar në një situatë më të qëndrueshme dhe të ekuilibruar; qetësim të përplasjes politike; zhvillimin e sistemit bankar dhe daljes në skenë të lojtarëve të tjerë të tregut financiar, Banka e Shqipërisë vlerësoi si të nevojshëm dy hapa:

- kalimin nga përdorimi i instrumenteve direkte në ato indirekte për zbatimin e politikës monetare; dhe
- synimin për të kaluar, në periudhë afatmesme, në një regjim të ri të politikës monetare, atë të *inflation targeting* (*inflacioni shënjestër*).

II.5.1. INSTRUMENTET E POLITIKËS MONETARE.

Zëvendësimi i instrumenteve direkte me ato indirekte u bë gradualisht me qëllim që të familjarizohej tregu me këtë ndryshim. Fillimisht u hoq kufiri i kreditit dhe më pas norma minimale e interesit për depozitat me afat në lekë për bankat shtetërore. Tashmë, sinjalizimi i politikës monetare realizohet me anë të normës fikse të interesit të repove në ankandet javore të organizuara nga Banka e Shqipërisë. Norma bazë e interesit miratohet nga Këshilli Mbikëqyrës. Çdo muaj ky Këshill merr në shqyrtim zhvillimet monetare në vend.

Kuadri aktual operacional i Bankës së Shqipërisë përfshin operacionet e shitblerjeve me të drejta të plota, të cilat i janë shtuar paketës së instrumenteve në fillim të vitit 2001.

Kredia njëditore është një instrument i ri, i cili i është shtuar paketës së instrumenteve të politikës monetare në shkurt të vitit 2001.

Depozita njëditore përfaqëson një instrument të prezantuar në shkurt të vitit 2001 për të ndihmuar bankat e nivelit të dytë të veprojnë me likuiditetin e tepërt, duke e depozituar atë vetëm për një ditë në Bankën e Shqipërisë.

Ndryshimet më të rëndësishme në instrumentin e rezervës së detyrueshme kanë qenë përdorimi i mesatares javore në llogaritjen e saj dhe lejimi i përdorimit të nivelit 5 për qind të rezervës nga bankat e nivelit të dytë. Një ndryshim tjetër i rëndësishëm, që u bë në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2000, ishte remunerimi i rezervës së detyrueshme.

II.5.2 TREGJET.

Tregjet e pazhvilluara vazhdojnë të mbeten një pikë e dobët në sistemin financiar shqiptar që pengon zbatimin me efikasitet të politikës monetare e reduktimin e ekonomisë jozyrtare; kufizon mundësinë e investimit dhe shtrembëron mekanizmin e përcaktimit me efikasitet të çmimit të tregut. Problemi kryesor edhe i atyre tregjeve që ekzistonin ishte konkurrenca e dobët në to.

Tregu i parasë pati një zhvillim më të dukshëm në raport me tregjet e tjera. Kjo u siguroi nëpërmjet nxitjes së individëve për të investuar në tregun primar të bonove të thesarit duke shtuar, sadopak, konkurrencën në të si dhe organizimin e ankandëve të repove dhe atyre të anasjellta. Po kështu, tregu ndërbankar u kthye në një tjetër alternativë financimi për bankat.

Tregu i këmbimeve valutore vazhdoi të shfaqej në dy përmasa: tregu zyrtar dhe tregu jozyrtar. Pësha e secilit element përbërës ishte e konsiderueshme, megjithatë mbeti tregu më konkurrent në vend. Tregu jozyrtar ka ardhur duke u zvogëluar si pasojë e nxitjes së çeljes së zyrave të këmbimit valutor (numri i zyrave të këmbimit valutor është rritur me 48 gjatë periudhës 1999–2002); rritjes së numrit të bankave dhe përmirësimit të produkteve të tyre; rritjes së besimit të publikut tek operatorët formalë

të tregut valutor; rritjes së kontrollit të organeve shtetërore të cilat kanë si objektiv të punës së tyre identifikimin dhe minimizimin e aktiviteteve informale.

Tregu i kapitaleve mbeti elementi më i pazhvilluar në bashkësinë e tregjeve. Përfundimisht Bursa e Tiranës u shkëput edhe administrativisht nga Banka e Shqipërisë në qershor të vitit 2002. Gjatë gjithë periudhës në fjalë nuk pati asnjë transaksion apo listim në Bursën e Tiranës ose përfshirje të saj në procesin e privatizimit.

Tregu i sigurimeve është një tjetër element i tregut financiar i cili po zhvillohet me ritme të kënaqshme. Në këtë treg tashmë veprojnë 5 operatorë të licencuar. Banka e Shqipërisë nuk është autoriteti mbikëqyrës i këtij tregu, megjithatë, zhvillimi i tij është i lidhur dhe ndikon në zhvillimin e tregut bankar dhe të operatorëve të tjerë të tregut financiar. Karakteristikë e tregut të sigurimeve është prania e ndjeshme e kapitalit vendas, në ndryshim nga tregu bankar që dominohet nga kapitali i huaj; konkurrenca në treg si dhe nevoja për privatizimin e institutit më të madh shtetëror, si pjesë e reformës financiare në vend. Zhvillimi i tregut të sigurimeve në vitet e fundit nxjerr në plan të parë nevojën e forcimit të aftësive mbikëqyrëse të tij dhe të përafrimit me standardet ndërkombëtare.

II.5.3 REZERVA VALUTORE DHE ADMINISTRIMI I SAJ.

Rezerva valutore bruto e Bankës së Shqipërisë gjatë periudhës 1999-2002 erdhi në rritje nga 520.8 milionë në 840.6 milionë dollarë amerikanë. Kjo rezervë, e shprehur në muaj importe ka ndryshuar nga 6.1 në fund të vitit 1999 në 6.9 në fund të muajit shtator 2002. Banka e Shqipërisë i kushtoi vëmendje jo thjesht ndërtimit të rezervës valutore, por edhe përmirësimit të administrimit të saj. U hartua dhe u miratua politika e administrimit të rezervës valutore e cila përcakton qartë objektivat për të vlerësuar këtë proces.

Prezantimi i euros si njësi monetare e vendeve të Bashkimit Monetar European, përfaqësoi një nga zhvillimet më të rëndësishme në plotësimin e masave për krijimin e një tregu të gjerë financiar european, të krahasueshëm me atë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Për të gjitha institucionet investuese, pra edhe për Bankën e Shqipërisë, alternativat e investimit janë shtrirë në të gjithë zonën e euros. Aktualisht, rezerva valutore mund të investohet në instrumentet e borxhit të të gjitha vendeve anëtare të Bashkimit Monetar European, në kushte të kënaqshme të likuiditetit dhe të tregtimit të tyre. Në të njëjtën kohë, janë krijuar mundësitë për reduktimin e kostove fikse në procesin e administrimit të rezervës, si rezultat i mbylljes së llogarive të tepërta.

II.6 Ngjarje të veçanta me të cilat u përball Banka e Shqipërisë.

II.6.1 HYRJA NË QARKULLIM FIZIK E MONEDHËS MË TË RE: EURO.

Një ngjarje e rëndësishme për 12 vendet e Bashkimit Europian ishte hyrja në qarkullim fizik e monedhës së përbashkët euro dhe zëvendësimi i monedhave ekzistuese të këtyre vendeve. Kjo ngjarje u shoqërua me aktivitete edhe në të gjitha vendet e tjera që në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë prekeshin nga ky fenomen. Banka e Shqipërisë u angazhua në fushatën njohëse të popullsisë me monedhën e re si dhe të përgatitjes për të patur në çdo kohë sasi të nevojshme dhe në prerjen e kërkuar për monedhën e re. Në tërësi, procesi i hyrjes fizike të euros kaloi pa probleme në Shqipëri. Ndikimi më i drejtpërdrejtë i këtij procesi ishte mbiçmimi (rreth 1.6 për qind ndaj usd dhe 1.8 për qind ndaj euros) i monedhës së vendit gjatë muajit dhjetor 2001, si pasojë e zëvendësimit të asaj pjese të kursimeve në valutat përbërëse të euros, e cila ishte mbajtur jashtë sistemit bankar. Për pasojë, pati rritje të ofertës monetare dhe të parasë jashtë bankave dhe Banka e Shqipërisë u detyrua të blejë valutë për të mos lejuar një mbiçmim të fortë artificial të lekut (rreth 20.5 milionë usd dhe 25.72 milionë euro). Në total vlerësohet se janë këmbyer rreth 131 milionë euro prej të cilave vetëm 29.5 për qind janë këmbyer fizikisht në sportel. Nëse euro do të kthehet në monedhë kryesore për ekonominë shqiptare, kjo mbetet për t'u verifikuar.

II.6.2 TËRHEQJA E DEPOZITAVE NGA SISTEMI BANKAR.

Në fund të muajit mars 2002, në dy bankat më të mëdha të vendit u shfaq fenomeni i tërheqjes së depozitave nga ana e popullsisë. Fenomeni u shfaq fillimisht në rajone të kufizuara të vendit dhe më pas u përhap edhe në rrethe të tjera. Kjo ngjarje ndodhi kur sistemi bankar shqiptar po kalonte periudhën më të mirë të zhvillimit të tij; kur po plotësohej paketa ligjore për të forcuar më tej besimin në këtë sistem dhe ekonomia po zhvillohej me ritme të kënaqshme. Fakti që depozituesit po shfaqnin mosbesim në banka, kryesisht në një periudhë të tillë, përbënte një problem serioz pasi tregonte se sistemi bankar ishte i brishtë dhe i ekspozuar kundrejt faktorëve spekulues dhe krizave politike dhe depozituesit shqiptarë kishin prirje të reagonin më me ashpërsi për shkak të përvojës së hidhur të vitit 1997.

Në këtë kuadër, Banka e Shqipërisë reagoi me një sërë masash dhe vendimesh dhe harmonizoi veprimtarinë e saj me institucione të tjera, kryesisht me Ministrinë e Financave.

Për herë të parë, Banka e Shqipërisë i dha prioritet afatshkurtër një tjetër objektiv, atij të ruajtjes së qëndrueshmërisë së sistemit bankar. Kjo u konkretizua në: heqjen dorë nga zbatimi i objektivave sasiorë të programit monetar; lejimin e financimit të deficitit të qeverisë dhe në rritjen e kufirit nga 5 në 8 për qind; hedhjen e likuiditetit në treg kryesisht nëpërmjet vënies në veprim të repove të anasjellta. Paralelisht, Banka e Shqipërisë rriti normat e

interesit për të nxitur edhe kthimin e parasë në sistem; zhvilloi një fushatë propagandistike dhe sqaruese për dëmet që vinin nga sjellja e depozituesve si dhe për elementet pozitive të ligjit të sapomiraturar në Kuvend për garantimin e depozitave.

Për periudhën 20 mars – fund qershorit 2002, nga sistemi bankar u tërhoqën 19.7 miliardë lekë depozita, prej të cilave 13.6 miliardë lekë dhe 6.1 miliardë lekë në valutë. Gjatë kësaj periudhe vetëm nga Banka e Kursimeve u tërhoqën 18.6 miliardë lekë. Fenomeni i tërheqjes së depozitave u konsiderua plotësisht i shuar në fund të qershorit 2002. Megjithatë, ndikimet negative të kësaj ngjarjeje u shfaqën në rritjen e parasë jashtë bankave; në rritjen e financimit të deficitit; në mungesën e likuiditetit në sistemin bankar; në nënçmimin e lekut me 0.1 për qind kundrejt dollarit amerikan si dhe në rritjen e inflacionit.

KAPITULLI III ZHVILLIMI I PËRGJITHSHËM I BANKËS SË SHQIPËRISË.

III.1 PRIORITETET E ZHVILLIMIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË.

Zhvillimi institucional i Bankës së Shqipërisë në tre vitet e ardhshme synon të ofrojë një plan veprimi të harmonizuar për të siguruar përmirësimin e punës në të gjitha drejtimet.

Në tre vitet e ardhshme, përveç trajtimit të të gjitha problemeve që ka banka qendrore, do të kërkohet përqendrimi më i madh në disa aspekte të cilat përbëjnë prioritetet për zhvillimin e institucionit.

Përgatitja për regjimin e ri të politikës monetare përbën një ndër drejtimet më të rëndësishme të veprimtarisë për periudhën 2003-2005. Gjatë kësaj periudhe do të forcohen aftësitë analizuese dhe parashikuese, të cilat do të ndihmojnë në përcaktimin e objektivave realistë të politikës monetare, në marrjen e vendimeve të duhura dhe në kohën e duhur. Për këtë, vëmendje do të ketë përmirësimi i sistemeve të grumbullimit, të përpunimit dhe të shpërndarjes së të dhënave.

Forcimi dhe zhvillimi i aftësive mbikëqyrëse përbën aspektin tjetër të rëndësishëm në zhvillimin e bankës qendrore në kushtet kur po shtohet numri i operatorëve në treg, po forcohet konkurrenca midis tyre, po rritet roli i sistemit bankar në ekonominë e vendit si dhe po zhvillohen produkte të reja e po zgjerohet aktiviteti.

Banka e Shqipërisë do të ketë në vëmendje rritjen e përgjegjshmërisë së saj institucionale dhe të transparencës për aktivitetin e saj.

Së fundi, por jo më pak e rëndësishme, Banka e Shqipërisë do t'i kushtojë kujdes zhvillimit të burimeve njerëzore dhe krijimit të kushteve të përshtatshme të punës, dy elementë këta të nevojshëm për përmbushjen e objektivave afatmesëm të përcaktuar në këtë plan zhvillimi.

III.2 OBJEKTIVI STRATEGJIK I BANKËS SË SHQIPËRISË - STABILITETI I ÇMIMEVE.

Objektivat strategjikë të një banke qendrore përshkruhen në ligjin e saj. E gjithë veprimtaria e bankës qendrore drejtohet prej kuadrit që i përcakton ligji dhe synon përmbushjen e objektivave ligjorë. Kjo përfaqëson edhe ato detyra të cilat i janë deleguar institucionit të bankës qendrore nga ana e politikëbërësve të shtetit shqiptar. Në këtë kuadër, Banka e Shqipërisë ka në kompetencë që të hartojë plane veprimi që çojnë në përmbushjen më të mirë dhe më efikase të objektivave strategjikë të përcaktuar në ligj.

“Arritja dhe ruajtja e stabilitetit të çmimeve” përbën objektivin kryesor dhe parësor të Bankës së Shqipërisë. Në funksion të këtij objektivi hartohet politika monetare; nxitet zhvillimi i tregut bankar; nxitet kreditimi; bëhet programimi monetar; bashkëpunohet me institucione të tjera për harmonizimin e politikave; komunikohet me publikun etj..

Në veprimtarinë praktike ky objektivi materializohet në mbajtje të inflacionit në nivele të ulëta pozitive. Për periudhën 2003-2005 Banka e Shqipërisë do të ndjekë si objektivi kryesor arritjen e inflacionit, që luhatet në kufijtë 2-4 për qind.

Në përcaktimin e aspektit sasior të objektivit kryesor dhe në hartimin e politikës monetare për t’i shërbyer përmbushjes së këtij objektivi, Banka e Shqipërisë do të ketë parasysh të respektojë pavarësinë e saj, si dhe të harmonizojë politikën e saj monetare me politikën për rritjen ekonomike, reduktimin e varfërisë, politikën fiskale dhe përpjekjet për konsolidimin fiskal, politikën e nxitjes së punësimit etj.. Duke vepruar në këtë mënyrë Banka e Shqipërisë vazhdon të kontribuojë në zhvillimin ekonomik të vendit dhe i përcakton objektivat dhe politikën e veta për këtë qëllim.

Mbajtja e inflacionit të ulët pozitiv ka gjetur argumente të shumta teorike mbi dobishmërinë në ekonominë e një vendi. Përveç kësaj, këto argumente janë vërtetuar edhe në praktikë, madje edhe në rastin e Shqipërisë. Shkurtimisht, inflacioni i ulët pozitiv siguron një mjedis të qëndrueshëm për marrjen e vendimeve për investime; rrit shkallën e garancisë së tyre dhe të parashikimit të fitimeve; ruan vlerën reale të kursimeve dhe të investimeve duke kontribuar, kështu, në mbështetjen e rritjes ekonomike. Me fjalë të tjera, redukton pasigurinë që rrethon vendimet ekonomike dhe krijon kushte të favorshme për rritje reale të qëndrueshme të ekonomisë. Nga ana tjetër, deflacioni krijon situata shtrëngimi jo të arsyeshme që ndikojnë negativisht në rritjen ekonomike dhe në punësim.

Shqipëria, si vend që synon të aderojë në BE, duhet të sigurojë edhe harmonizim në objektivin e inflacionit. Në Zonën e Euros objektivi është që inflacioni të mos rritet më tepër se 2 për qind. Për këtë arsye, përcaktimi i objektivit 2-4 për qind duket i arsyeshëm dhe në përputhje me objektivat e integritetit pasi:

- është një objektivi sasior që klasifikohet në grupin e inflacionit të ulët;

- është pranë objektivit të Bankës Qendrore Europiane, me një devijim maksimal, relativisht të ulët (2 pikë përqindjeje) po të krahasohen nivelet e zhvillimit të tregjeve dhe të ekonomisë;
- është objektiv i afërt me inflacionin e Zonës së Euros gjë që nxit qëndrueshmëri të kursit të këmbimit në raport me euron. Kjo qëndrueshmëri është e rëndësishme në kushtet kur inflacioni në Shqipëri ndikohet në masë të konsiderueshme nga ecuria e kursit të këmbimit dhe pjesa më e madhe e importeve vjen nga Zona e Euros.

Megjithatë, objektivi i Bankës së Shqipërisë është më i lartë pasi në Shqipëri zhvillimi ekonomik dhe i tregjeve është ende larg Zonës së Euros. Në ekonominë shqiptare ende ndodhin ndryshime strukturore dhe zhvillohen reforma, të cilat në një mënyrë ose në tjetrën ndikojnë mbi inflacionin. Inflacioni në Shqipëri ndikohet ndjeshëm nga inflacioni i importuar. Në kushtet kur për periudhën afatmesme nuk pritet reduktim i fortë i importeve dhe rritje e ndjeshme e eksporteve, inflacioni do të vijojë të ndikohet nga elementi i inflacionit të importuar. Partnerët kryesorë tregtarë të Shqipërisë, Italia dhe Greqia kanë inflacion mesatar vjetor përkatësisht 2.6 dhe 3.8 për qind (viti 2002). Vendet e rajonit, me të cilat pritet të gjallërohet tregtia pas nënshkrimit të marrëveshjeve të tregtisë së lirë, kanë inflacion që luhet në intervalin nga 1.5 në 41 për qind. Kjo ndikon në ruajtjen e presioneve për inflacion disi më të lartë në Shqipëri se në Zonën e Euros.

Objektivi i Bankës së Shqipërisë, i cituar më sipër, është arritja e inflacionit mesatar vjetor prej 3 për qind. Por, ky objektiv konvertohet në intervalin 2-4 për qind duke patur parasysh paqëndrueshmërinë e ekonomisë shqiptare dhe transmetimin joefikas të vendimeve të politikës monetare në ekonomi, me qëllim që banka qendrore të ketë fleksibilitet më të lartë për të vepruar dhe njëkohësisht të forcojë besueshmërinë e saj si institucion tek publiku. Këto masa janë të nevojshme për të rritur pavarësinë dhe përgjegjshmërinë.

Objektivi i inflacionit shprehet si rritje vjetore e çmimeve të konsumit. Aktualisht ai matet me normën në fund të vitit. Marrja parasysh e ndryshimit vjetor eliminon ndikimin e faktorëve sezonalë. Por, duke u bazuar vetëm në normën në fund të vitit, rezultati i inflacionit nuk është i imunizuar nga faktorë të rastit, rregullime të çmimeve të administruara apo ndryshime të taksave indirekte. Kjo shkakton devijime nga objektivi në fund të vitit, megjithëse veprimet e bankës qendrore kanë qenë në përputhje me politikën monetare dhe në shërbim të objektivit. Sqarimi në publik është hapi më i rëndësishëm për të komunikuar këtë fakt. Megjithatë, përsëritja e fenomeneve të tilla, çon në gërryerje të besueshmërisë së bankës qendrore. Për të reduktuar përsëritjen e ngjarjeve të tilla, një përafrim më i përshtatshëm konsiderohet norma mesatare vjetore e inflacionit. Duke përdorur nivelet mesatare reduktohet veprimi i faktorëve të rastësishëm, por njëkohësisht rritet presioni mbi bankën qendrore për të ruajtur objektivin e inflacionit gjatë gjithë vitit dhe jo të bëjë veprime rregullative në fund të tij që të quhet se respektoi objektivin.

Gjatë vitit 2003 Banka e Shqipërisë do të vijojë të masë respektimin e objektivit me normën vjetore të inflacionit të shpallur në fund të vitit. Njëkohësisht, gjatë vitit 2003, Banka e Shqipërisë do të publikojë rregullisht normën mesatare të inflacionit vjetor për të familjarizuar publikun me të dhe për ta përgatitur në kalimin drejt saj në të ardhmen. Paralelisht me këtë veprim, Banka e Shqipërisë do të rishikojë

metodologjinë e llogaritjes së inflacionit bazë dhe do ta konsultojë me institucionet financiare ndërkombëtare dhe me INSTAT, për të konkluduar në një normë të përshtatshme brenda gjashtëmuajorit të parë të vitit 2003. Në gjashtëmuajorin e dytë të vitit 2003 do të fillojë publikimi i inflacionit bazë. Nëpërmjet bërjes publike të këtij inflacioni Banka e Shqipërisë do të rrisë shkallën e transparencës dhe të përgjegjshmërisë së veprimeve të saj dhe të ndikimit mbi inflacionin. Megjithatë, inflacioni bazë nuk do të kthehet menjëherë në objektiv. Kjo për shkak të problemeve që krijon kjo kategori me transparencën dhe besueshmërinë. Duke qenë se inflacioni bazë, si rregull, rezulton pasi nga shporta e mallrave të konsumit përjashtohen ato mallra me luhatshmëri më të lartë dhe në rastin e shportës në Shqipëri gati gjysmën e saj e përbëjnë mallra me luhatshmëri të lartë, kjo kategori do të ulte besueshmërinë për bankën qendrore dhe do të krijonte baza për të ulur nivelin e përgjegjshmërisë. Për këtë arsye, adoptimin e kësaj kategorie si normë objektiv, Banka e Shqipërisë do ta paraprijë me fushatë të gjerë dhe intensive sensibilizimi të opinionit publik.

Së fundi, e rëndësishme është edhe matja e saktë e inflacionit. Vrojtimi i bërë nga INSTAT gjatë vitit 2000 dhe botimi i inflacionit mbi bazën e shportës së re, dhanë një kontribut të konsiderueshëm në përmirësimin e këtij treguesi. Megjithatë, ndryshimet në Shqipëri, të shpeshta dhe të menjëhershme, diktojnë nevojën e rishikimit me qëllim saktësimi të shportës së mallrave të konsumit. Për këtë arsye, Banka e Shqipërisë do të kërkojë dhe do të asistojë INSTAT për kryerjen e vrojtimit përkatës brenda periudhës 2004-2005 me synim publikimin e inflacionit të ri në janar 2006.

III.3 REGJIMI I POLITIKËS MONETARE DHE I KËMBIMEVE VALUTORE, INSTRUMENTET PËR ZBATIMIN E TYRE.

Banka e Shqipërisë përcakton regjimin e politikës monetare dhe të këmbimeve valutore në vend. Pavarësia e njohur me ligj i krijon Bankës së Shqipërisë hapësira për të shprehur pavarësinë reale nëpërmjet orientimit të politikës monetare të saj tërësisht drejt ruajtjes së stabilitetit të çmimeve. Nga ana tjetër, përcaktimi i regjimeve do të jetë në harmoni edhe me politikën e përgjithshme të zhvillimit ekonomik të vendit, për shkak të ndikimit të konsiderueshëm që kanë në ekonomi.

Në Shqipëri zbatohet regjimi i politikës monetare i përcaktuar si *targetim* monetar. Ky regjim, duke patur si objektiv përfundimtar inflacionin, vendos si objektiv të ndërmjetëm rritjen vjetore të ofertës monetare dhe përcakton tre objektiva sasiore, të emërtuar: kredia e brendshme neto për qeverinë; mjetet e brendshme neto të Bankës së Shqipërisë dhe rezerva valutore neto e Bankës së Shqipërisë. Tre objektivat sasiore janë të detyrueshëm për zbatim. Thelbi qëndron në konceptimin e inflacionit si fenomen kryesisht monetar në periudha afatgjata dhe sigurimin e inflacionit të ulët duke kufizuar rritjen e ofertës së parasë. Ky regjim zbatohet me sistemin e instrumenteve indirekte monetare të Bankës së Shqipërisë. Në praktikë, Banka e Shqipërisë ka avancuar duke e rritur theksin mbi përmbushjen e objektivit të inflacionit.

Megjithatë, inflacioni në vende si Shqipëria nuk është fenomen kryesisht monetar dhe në situata të caktuara ndikohet ndjeshëm nga faktorë të tjerë. Gjithashtu, përqendrimi ekskluzivisht në këtë tregues nuk merr parasysh edhe një sërë faktorësh të tjerë që ndikojnë në nivelin e çmimeve, si treguesit fiskalë dhe ata të kursit të këmbimit. Sasia e lartë e parasë në qarkullim në Shqipëri redukton lidhjen midis inflacionit dhe M3. Në këto kushte, Banka e Shqipërisë ka gjykuar si më të përshtatshëm kalimin në një regjim tjetër të politikës monetare, i cili do të mund t'i japë më tepër theks inflacionit. Si regjim i përshtatshëm është konsideruar regjimi i inflacionit shënjestër (*inflation targeting*), i cili është regjimi më i pranuar dhe më i përdorur në vendet e zhvilluara, por edhe në tranzicion. Ky regjim merr parasysh një numër të gjerë faktorësh të cilët ndikojnë mbi inflacionin dhe ecën paralelisht me zhvillimin e tregjeve financiare dhe përmirësimin e instrumenteve të Bankës së Shqipërisë.

Synimin për të ndryshuar regjimin e politikës monetare, Banka e Shqipërisë e ka bërë publik dhe ka filluar përgatitjet e nevojshme për këtë qëllim. Në deklaratimet e veta publike Banka e Shqipërisë ka renditur edhe arsyet pro ndërrimit të regjimit të politikës monetare si dhe kushtet që duhen plotësuar për këtë hap. Në këtë kuadër është konkluduar se afërsisht do të:

- ruhet regjimi aktual i politikës monetare për periudhën afatmesme 2003-2005;
- përgatitet për regjimin e ri të politikës monetare. Intensifikimi i këtyre përgatitjeve në vitet 2005-2006;
- sigurohet konsensusi për këtë regjim në vitin 2006;
- fillojë zbatimi i regjimit në vitin 2007.

Regjimi i këmbimeve valutore i zbatuar në vend është ai i kursit të lirë të këmbimit. Ky regjim është një parakusht i rëndësishëm për regjimin e inflacionit shënjestër. Si i

tillë, Banka e Shqipërisë nuk ka në objektivat e saj ndërrimin e regjimit të kursit të këmbimeve. Kjo do të thotë që Banka e Shqipërisë nuk do të kërkojë të arrijë ndonjë nivel të caktuar të kursit të këmbimit të Lekut kundrejt monedhave të tjera. Gjithashtu, Banka e Shqipërisë nuk shpall asnjë angazhim konkret në lidhje me ndërhyrjet në tregun valutor. Përsa i përket shitblerjeve në tregun valutor Banka e Shqipërisë do të vijojë të jetë e pranishme në rastet kur ka nevojë të sheshohen lëvizjet spekulative në tregun e vendit si dhe të riorganizojë ndërhyrjet pasive (shitblerje nga llogaritë, sidomos të Ministrisë së Financave) për të siguruar respektimin e objektivave të saj.

Banka e Shqipërisë mbështetet në përdorimin e instrumenteve monetare indirekte të cilat, në tërësi, janë në përputhje me kuadrin e instrumenteve të BQE. Objektivi kryesor do të jetë përmirësimi i përdorimit të këtyre instrumenteve për të rritur eficiencën në përdorimin e tyre si dhe përafrimi i plotë me instrumentet e BQE.

Kuadri shoqëruar i instrumenteve të tjera konsiderohet i plotë. Zbatimi i tyre do të jetë në funksion të situatës së likuiditetit në treg dhe të rritjes së efikasitetit të transmetimit të vendimeve të politikës monetare në ekonomi. Ndërkohë, përafrimi me BQE do të bëhet paralelisht me zhvillimin e tregjeve.

Instrumenti kryesor për sinjalizimin e politikës monetare do të vijojë të mbetet marrëveshja e riblerjes dhe norma e interesit të saj do të luajë rolin e normës bazë në ekonomi. Për përdorimin efektiv të instrumentit të marrëveshjeve të riblerjes, kërkohet njohja e plotë e kolateralit si edhe e vlerës së tij. Objektivi afatmesëm për Bankën e Shqipërisë është vlerësimi i kolateralit me vlerën e tregut në çdo transaksion të Bankës ku kërkohet përdorimi i tij. Nga ana tjetër, kërkohet zhvillimi i tregjeve të letrave me vlerë në Republikën e Shqipërisë. Për këtë arsye, nxitja e tregtimit të këtyre letrave përbën një objektiv afatmesëm që do të realizohet:

- duke krijuar bazën e nevojshme rregullative për trajtimin e vlerës së kolateralit dhe mënyrën e përcaktimit të saj. Për këtë do të punohet bashkërisht me Ministrinë e Financave për të zgjidhur afatin e maturimeve të letrave me vlerë të emetuara;
- duke nxitur format elektronike të tregtimit dhe automatizimin e procedurave në hedhje, përpunim, kontabilizim e ruajtje informacioni. Në këtë mënyrë do të përmirësohen aftësitë përpunuese të dokumentacionit dhe të informacionit të tregut primar të letrave me vlerë të Qeverisë si dhe do të ndihmohet zhvillimi normal i tregut sekondar të këtyre letrave.

Vëmendje të veçantë do të marrin dy aspekte:

- administrimi i rezervës valutore; dhe
- rezerva e detyrueshme që mbajnë bankat tregtare në Bankën e Shqipërisë.

III.3.1. REZERVA VALUTORE.

Objektivi kryesor në lidhje me administrimin e rezervës valutore është rritja e vlerës së saj duke siguruar rrezik të ulët në investim. Kuadri i administrimit të rezervës valutore përbëhet nga politika; komiteti i investimit; rregullat për funksionimin e komitetit dhe ky kuadër vlerësohet i plotë.

Objektivi për të ardhmen mbetet rritja e kthyeshmërisë nga investimi i rezervës valutore dhe vlerësimi i saj kundrejt objektivave sasiore të përcaktuar, diversifikimi i portofolit të investimit për të reduktuar rrezikun dhe rritja e numrit të bankave partnere si dhe e instrumenteve që përdoren në operacionet e investimit.

Për periudhën afatmesme, administrimi i rezervës valutore do të kryhet nga Banka e Shqipërisë duke patur parasysh përvojën e arritur në këtë drejtim në Bankën e Shqipërisë; mungesën e përvojave të tilla në institucione të tjera (brenda vendit); lidhjen organike që ekziston midis administrimit të rezervave valutore dhe ndikimit të kursit të këmbimit, nga njëra anë, dhe objektivave të politikës monetare, nga ana tjetër, si edhe pavarësinë që kërkohet për realizimin e objektivave në këtë drejtim.

Politika e administrimit të rezervës valutore, parashikon që një pjesë e fondeve të administrohen prej administratorëve të jashtëm. Shfrytëzimi në praktikë i kësaj mundësie, do të realizohet kur kushtet ligjore dhe teknike të çdo marrëdhënieje të mundshme biznesi të kësaj natyre do të jenë më të qarta për vetë Bankën e Shqipërisë. Në këtë drejtim, do të shfrytëzohet më mirë përvoja e bankave qendrore të cilat e zbatojnë këtë mundësi.

Ndryshimi i politikës së administrimit të rezervave valutore me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të saj, do të kryhet çdo vit. Së pari, do të synohet përcaktimi i saktë i rolit dhe i përgjegjësive të të gjithë punonjësve që merren me këtë veprimtari si edhe shndërrimi i punës së tyre në një aktivitet të matshëm nga pikëpamja financiare. Së dyti, do të synohet që kuadri rregullativ të pasurohet me konceptet e rrezikut dhe të ecurisë së investimit dhe t'i pasqyrojë ato në mënyrë të kuptueshme dhe të realizueshme.

III.3.2. REZERVA E DETYRUESHME DHE ROLI I HUADHËNËSIT TË FUNDIT.

Tendenca do të jetë reduktimi i përqindjes për mbajtjen e rezervës së detyrueshme në nivelin 2 për qind në fillim të fazës së tretë të BME. Kjo do të bëhet gradualisht, në përputhje me politikën monetare të zbatuar nga Banka e Shqipërisë dhe gjendjen e likuiditetit në tregun bankar.

Për këtë arsye, brenda gjashtëmujorit të parë të vitit 2003, do të përfundojë studimi që do të përcaktojë përputhjen e këtij instrumenti gradualisht me standardin e BQE. Mbi këtë bazë do të sigurohen dhe ndryshimet e nevojshme në periudhën afatmesme e madje dhe afatgjatë.

Banka e Shqipërisë do të synojë që të nxisë aktivitetin e tregut ndërbankar. Qëllimi është që bankat tregtare të synojnë të plotësojnë nevojat e tyre për likuiditet në këtë treg dhe jo duke iu drejtuar menjëherë Bankës së Shqipërisë.

III.4 PAVARËSIA, PËRGJEGJSHMËRIA, BESUESHMËRIA DHE TRANSPARENCA E BANKËS SË SHQIPËRISË.

Të katër këta elementë janë karakteristikë për çdo bankë qendrore dhe kontribuojnë në përmbushjen e objektivave të saj. Akoma më i rëndësishëm bëhet zhvillimi i këtyre tipareve nën regjimin e inflacionit shënjestër.

Në ndryshim me periudhën 1999-2002, Banka e Shqipërisë ka një vizion më të qartë në drejtim të zhvillimit të këtyre tipareve, për shkak të vëmendjes së konsiderueshme që morën ato në tre vitet e kaluara.

Në tre vitet e ardhshme do të synohet:

- rritja e shkallës së profesionalizmit në Bankën e Shqipërisë, gjë që do t'i sigurojë vendimmarrje më të mbështetur;
- rritja e përgjegjshmërisë në veprimet e Bankës nëpërmjet kujdesit për të raportuar më cilësisht në Kuvendin e Shqipërisë por edhe duke punuar për të qenë e pranishme në diskutimin e politikave dhe të projekteve ekonomike me vlerë kombëtare dhe për të harmonizuar politikën e saj monetare me politikat ekonomike;
- rritja e transparencës e cila do t'i sigurojë mbështetje në publik për veprimet e saj. Objektiv i më kryesor në këtë drejtim është sigurimi i përmbushjes së plotë të standardeve të Kodit të Transparencës për Praktika të Mira të Politikave Monetare, hartuar nga FMN, brenda vitit 2004. Në drejtim të rritjes së transparencës Banka e Shqipërisë do të përqendrojë vëmendjen në këto grupe kryesore: popullsinë, bizneset dhe media. Kjo do ta ndihmojë të krijojë lobe të përshtatshme për të mbështetur politikën e saj;
- sqarimi i mëtejshëm i klasifikimit të informacionit në sekret dhe jo për përdorim publik. Për këtë, brenda majit 2003 do të rishikohet udhëzimi përkatës për ta harmonizuar me rregulloren e re "Për transparencën dhe konfidencialitetin në Bankën e Shqipërisë" si dhe për të interpretuar saktë dhe qartë klasifikimet;
- rritja e besueshmërisë në institucionin e bankës qendrore nëpërmjet angazhimit për të arritur objektivat; ndërgjegjësimit dhe edukimit të publikut për politikat ekonomike; financiare dhe veprimtarinë e bankës qendrore;
- rritja e kontributit në zhvillimin e tregjeve, zhvillimin e sistemit bankar, shëndoshjen e sistemit financiar duke forcuar mbikëqyrjen bankare dhe duke ndihmuar në forcimin e autoriteteve të tjera mbikëqyrëse dhe të Agjencisë së Garantimit të Depozitave dhe për të krijuar kushtet për reduktimin deri në ndërprerjen e financimit të drejtpërdrejtë të Qeverisë prej Bankës së Shqipërisë;
- ruajtja e pavarësisë në marrjen e vendimeve të bankës qendrore për të mos lejuar ndikimin e tyre jo vetëm nga vendimet e ekzekutivit por edhe nga interesat e grupeve të fuqishme financiare ose ekonomike private ose nga pritshmëritë e tregut;
- rritja e transparencës në veprimtarinë financiare të Bankës së Shqipërisë dhe ndërtimi i një platforme, brenda muajit shkurt 2003, për ruajtjen e reputacionit të institucionit duke qartësuar që detyrat kryesore mbi bazën e të cilave vlerësohet puna e bankës qendrore janë kontributi në ruajtjen e qëndrueshmërisë së çmimeve dhe në zhvillimin e sistemit bankar. Kjo platformë do të shërbejë për të mbrojtur reputacionin e institucionit sa herë që vihet nën presionin e lojës politike;
- rritja e angazhimit publik të Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë për të siguruar shpjegim të politikave dhe vendimeve të bankës qendrore dhe transmetimin e mesazheve të rëndësishme.

III.5 EDUKIMI I PUBLIKUT DHE MARRËDHËNIET ME TË.

Edukimi i publikut dhe marrëdhëniet me të do të kenë rolin qendror në përpjekjet për të rritur transparencën dhe për të fituar “elektorat”. Ky element ka nevojë të zhvillohet për të shtuar shkallën e të kuptuarit të problemeve dhe për të fituar edhe ato grupe vëmendja e të cilave tërhiqet më me vështirësi. Në këtë mënyrë:

- do të ofrohet një seri periodike botimesh sqaruese dhe edukuese për popullsinë në formën e broshurave dhe të fletëvolanteve;
- do të përmirësohet cilësia e materialeve të botuara si nga pikëpamja e përmbajtjes, gjë që e mbështet përvoja e fituar në fushën e botimeve, ashtu edhe ana pamore e botimeve;
- do të përmirësohet ambjenti i lejueshëm për t’u vizituar nga publiku për ta bërë më komod afrimin e publikut me Bankën;
- do të organizohet një seri muzeumesh në ambjentet e Bankës ose në Galerinë e Arteve apo Muzeun Kombëtar, me objekte numizmatike që Banka e Shqipërisë disponon, të kombinuara me mjete të thjeshta shpjeguese për aktivitetin e saj të tanishëm, duke ofruar më shumë informacion të natyrës historike për publikun;
- do të synohet tërheqja e vëmendjes të grupmoshave më të reja të popullsisë si nxënësit e të gjithë sistemit arsimor, të cilët janë “elektorati” i ardhshëm i Bankës së Shqipërisë, për të rritur në këtë mënyrë cilësinë e tij. Kjo do të bëhet duke i dedikuar një pjesë të programit të botimeve në formë të shtresëzuar për sistemin arsimor apo duke mbajtur takime dhe leksione;
- do të synohet rikonceptimi i marrëdhënieve me median me qëllim që të krijohen grupet e mediave që transmetojnë në publik qëndrimet e saj pa shtrembërime apo keqinterpretime;
- do të forcohet roli i Bankës së Shqipërisë si analiste dhe këshilltare e Qeverisë për çështjet e ekonomisë dhe të financës.

Faqja e internetit e Bankës së Shqipërisë është një tjetër mënyrë komunikimi e institucionit me publikun. Për të ardhmen ka rëndësi që përdorimi i saj të jetë më i lehtë si dhe të pasurohet me rubrika të reja (për shembull, rubrika e Europës) në përputhje me interesat dhe nevojat që krijohen për Bankën e Shqipërisë.

Përveç këtyre masave, vëmendje do t’i kushtohet intensifikimit të aktivitetit të zëdhënësit të shtypit. Zëdhënësi i shtypit përfaqëson një post të caktuar në Bankën e Shqipërisë. Megjithatë, zhvillimi i aktivitetit të zëdhënësit do të marrë rëndësi të veçantë bazuar në objektivat ambiciozë për rritje transparence dhe të komunikimit me publikun. Në këtë këndvështrim, zëdhënësi i shtypit do të jetë personi që paraqet qëndrimin zyrtar të Bankës së Shqipërisë si dhe ka në “administrim” konferencat e shtypit të Bankës së Shqipërisë. Zëdhënësi i shtypit është pika e kontaktit midis Bankës së Shqipërisë dhe medias dhe siguron komunikimin e ndërsjellë me të.

III.6 REFORMA NË SISTEMIN FINANCIAR.

Zhvillimi i reformës në sistemin financiar është një ndër objektivat më të rëndësishëm në periudhën afatmesme 2003-2005 të Qeverisë Shqiptare. Zhvillimi me sukses i kësaj reforme kërkon angazhimin e institucioneve të ndryshme, ku Banka e Shqipërisë është një ndër institucionet kryesore dhe më të interesuara për këtë proces. Reforma në sistemin financiar do të synojë krijimin e një tregu financiar efektiv dhe konkurrues, në mbështetje të zhvillimit ekonomik të vendit. Reforma e sistemit financiar do të shihet në këto aspekte:

- **Privatizimi i Bankës së Kursimeve**, përfaqëson hapin më të rëndësishëm të reformës në sistemin financiar për pozicionin dominues që ka kjo bankë në sistemin bankar shqiptar, rëndësinë për zbatimin e politikës buxhetore dhe monetare. Banka e Shqipërisë është shprehur se privatizimi i Bankës së Kursimeve duhet të sigurojë thithjen e investitorëve të huaj me reputacion që premtojnë për zhvillim të produkteve bankare, përmirësim të cilësisë së shërbimeve, reduktim të kostos së shërbimeve dhe kthimin e bankës në një institucion të shëndoshë e të sigurt. Banka e Shqipërisë këmbëngul që privatizimi i Bankës së Kursimeve të sigurojë nxitje konkurrence gjë që do të përmirësojë funksionimin e sistemit bankar dhe do të rrisë eficiencën e zbatimit të politikës monetare. Për këtë, Banka e Shqipërisë ka ofruar gjithnjë gatishmëri për të diskutuar dhe bashkërenduar me Ministrinë e Financave.
- **Zgjidhja e problemit të pronarit të Bankës Kombëtare Tregtare**, është një aspekt tjetër i rëndësishëm që ka të bëjë me rritjen e sigurisë së kësaj banke dhe me angazhimin më aktiv të saj në sistemin bankar, duke ndihmuar në zhvillimin e mëtejshëm të sistemit bankar shqiptar.
- **Zbatimi i një politike licencimi të kujdesshme me karakter përzgjedhës** duke i dhënë prioritet atyre bankave që premtojnë zhvillime në ato rajone e produkte ku sot ka mangësi.
- **Forcimi i aftësive mbikëqyrëse dhe rregullatore të Bankës së Shqipërisë**, nëpërmjet zhvillimit të Departamentit të Mbikëqyrjes, krijimit dhe forcimit të strukturave për mbrojtjen, për nxitjen e konkurrencës dhe luftën kundër abuzimit me pozitën dominuese në tregun bankar si dhe të bazës përkatëse ligjore e rregullative, përmirësimit të aftësive analizuuese e inspektuese.
- **Rishikimi dhe përmirësimi i ligjit “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”**, për të përforcuar kërkesat për licencimin e bankave, raportimin e gjendjes financiare të tyre dhe për përcaktimin më të qartë të marrëdhënieve me personat e lidhur me bankën etj..
- **Nxitja e krijimit të subjekteve financiare jobanka**, si mjet për tërheqjen e kapitalit shqiptar në sistemin financiar dhe si mjet për të nxitur krijimin e bankave shqiptare.
- **Krijimi i Zyrës së Informacionit për Kreditë dhe Transferta**, zyrë e cila do të imponojë më tepër disiplinë në lidhje me klientët e angazhuar në të tilla veprime dhe do të rrisë shkallën e informacionit për të punuar me klientë të sigurt.
- **Nxitja e konkurrencës**, në tërësi, në sistemin financiar si pjesë e përpjekjeve të përbashkëta me Ministrinë e Financave dhe me Ministrinë e Ekonomisë. Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet marrjes së masave për reduktimin e dominimit të tregut bankar prej Bankës së Kursimeve.

- **Forcimi i autoriteteve mbikëqyrëse dhe forcimi i kërkesave për raportim e transparencë** nga institucionet financiare që licencohen jo prej Bankës së Shqipërisë, në bashkëpunim me institucionet përkatëse, kryesisht me Ministrinë e Financave.
- **Krijimi i skemave të garantimit të kredive**, si institucione që do të ndihmojnë në nxitjen e kreditimit të ekonomisë, zhvillimin e sistemit bankar, lidhjen më të ngushtë të tij me pjesën tjetër të ekonomisë dhe përmirësimin e mekanizmit të transmissioinit e të ndërmjetësimit bankar.
- **Forcimi i aftësive të Agjencisë së Trajtimit të Kredive**, si pjesë e përpjekjeve për të forcuar disiplinën financiare në treg; shtimi i kërkesave për raportim dhe transparencë të kësaj agjencie si dhe studimi i mundësive për kthimin e saj në një agjenci *forfeiting*-u.
- **Forcimi i bazës ligjore dhe institucionale** për aspekte të tilla si falimenti dhe shlyerja e borxheve; **rishikimi i ligjit “Për kontabilitetin”** dhe forcimi i kërkesave për raportim.
- **Privatizimi i shoqërisë shtetërore të sigurimeve** do të ndihmojë në rritjen e konkurrencës në këtë treg dhe në zgjerimin e pjesëmarrjes aktive të këtij segmenti të tregut financiar në jetën ekonomike.
- **Forcimi i aftësive të autoritetit të luftës kundër pastrimit të parave** dhe bashkëpunimi i ngushtë me Bankën e Shqipërisë. Si autoritet mbikëqyrës dhe rregullator, Banka e Shqipërisë është e interesuar që sistemi bankar të veprojë në përputhje me rregullat në fuqi dhe të jetë i imunizuar nga përpjekjet për përfshirjen e tij në aktivitete jo të pastra.

Sistemi financiar forcohet edhe nëpërmjet zbatimit të standardeve dhe kodeve ndërkombëtare të hartuara për këtë qëllim. Për këtë arsye, si pjesë e reformës financiare duhet parë edhe vlerësimi i shkallës së respektimit të tyre dhe ndërtimi i programeve për përmbushjen sa më të plotë. Sistemi i kodeve dhe i standardeve i përket një grupi institucionesh. Megjithatë, Banka e Shqipërisë është e angazhuar për të dhënë kontributin e vet në përmbushjen e kodeve dhe të standardeve që lidhen drejtpërdrejt me politikën monetare dhe me dhënien e vlerësimeve të pavarura e mbi këtë bazë të rekomandimeve edhe për kodet e tjera si më poshtë:

- **Kodi i Praktikave të Mira të Transparencës në Politikat Monetare dhe Financiare.** Standardet e këtij Kodi janë vlerësuar dhe brenda vitit 2005, Banka e Shqipërisë synon të jetë plotësisht në përputhje me to.
- **Kodi i Praktikave të Mira për Transparencën Fiskale.** Banka e Shqipërisë do të synojë të bëjë një vlerësim të pavarur brenda marsit të vitit 2003.
- **Shpërndarja e të dhënave.** Banka e Shqipërisë do të synojë të bëjë një vlerësim të pavarur brenda qershorit të vitit 2003.
- **Parime dhe Udhëzime për Paaftësi Paguese Reale dhe Sistemet e të Drejtave të Kreditorëve.** Banka e Shqipërisë do të synojë të bëjë një vlerësim të pavarur brenda dhjetorit të vitit 2003.
- **Parimet e Qeverisjes së Ndërmarrjes.** Banka e Shqipërisë do të synojë të bëjë një vlerësim të pavarur brenda marsit të vitit 2004.
- **Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit.** Banka e Shqipërisë është përgjithësisht në përputhje me këto standarde. Një rivlerësim i tyre parashikohet të bëhet brenda qershorit të vitit 2003.

- **Standarded Ndërkombëtare të Kontrollit.** Banka e Shqipërisë do të synojë të bëjë një vlerësim të pavarur brenda vitit 2003; do të përcaktojë planin e veprimeve për përmbushje të tyre në kuadër të bankës qendrore deri në fund të vitit 2004.
- **Parimet bazë më të rëndësishme për Sistemet e Pagesave.** Banka e Shqipërisë do të synojë të bëjë një vlerësim të pavarur brenda shtatorit të vitit 2004.
- **40 Rekomandimet për Pastrimin e Parave.** Banka e Shqipërisë do të synojë të bëjë një vlerësim të pavarur brenda dhjetorit të vitit 2003.
- **Parimet Bazë për Mbikëqyrje Bankare Efektive.** Banka e Shqipërisë është vlerësuar përgjithësisht në përputhje me këto parime. Çdo vit bëhet rivlerësimi i tyre.
- **Objektivat dhe Parimet e Rregullave për Letrat me Vlerë.** Banka e Shqipërisë do të synojë të bëjë një vlerësim të pavarur brenda marsit të vitit 2004.
- **Parimet Bazë të Sigurimeve.** Banka e Shqipërisë do të synojë të bëjë një vlerësim të pavarur brenda dhjetorit të vitit 2003.

Në përfundim të vlerësimeve të tilla, Banka e Shqipërisë do të bëhet iniciatore për të kërkuar asistencën e Departamentit MAE në FMN që të ofrojë vlerësimin e tij për këtë grup kodesh në gjysmën e dytë të vitit 2004.

III.7 Integrimi në Bashkimin Europian.

Integrimi në Bashkimin Europian është shpallur si objektiv strategjik i Shtetit Shqiptar, një ndër objektivat që gëzon edhe konsensusin në rradhët e popullsisë dhe të politikës. Banka e Shqipërisë është pjesëmarrëse në procesin e integritit duke qenë anëtare e organizmave përkatës të krijuar brenda vendit. Megjithatë, në këtë proces, Banka e Shqipërisë ka një rol më të veçantë pasi përqendrimi i saj do të jetë kryesisht në politikën monetare dhe të kursit të këmbimit si dhe në direktivat europiane për mbikëqyrjen bankare, legjislacionin bankar dhe statistikat. Në këtë kuadër, Bankës së Shqipërisë i duhet gradualisht të zhvillojë aktivitetin e vet që të harmonizohet e të përafrohet me kërkesat e Bashkimit Europian.

Programi i punës për kontributin në procesin e integritit është ndarë në dy faza. **Faza e parë është titulluar: “Çfarë do të thotë të hysh në Europë”.** Kjo fazë ka karakter njohës dhe orientues në lidhje me institucionet, me kërkesat, me legjislacionin dhe me hapat e integritit për të kuptuar se sa larg është Shqipëria nga ky proces. Kjo fazë mendohet të shoqërohet me krijimin e dhomës për Europën, e arkivës me dokumentet për Europën si dhe me seminare shpjeguese. Faza ka filluar të zbatohet në gjysmën e dytë të vitit 2002 dhe pritet të përfundojë brenda gjysmës së parë të vitit 2003.

Gjatë kësaj faze identifikohen dhe bankat qendrore të vendeve në tranzicion që do të ndiqen si modele në bazë të stadiut të ecurisë; të problemeve dhe të traditave të ngjashme.

Faza e dytë do të jetë fillimi i zbatimit të hapave konkretë për integrimin në Europë. Për të hyrë në fazën e dytë do të përgatitet programi afatgjatë deri në mars të vitit 2003, pasi të jetë zhvilluar shkalla njohëse e Europës ndër punonjësit e bankës. Deri në fund të muajit mars të vitit 2003 do të përfundojë rregullimi i ambjentit për Europën në hollin kryesor të Bankës së Shqipërisë.

Integrimi evropian kërkon edhe familjarizim të publikut me këtë proces. Banka e Shqipërisë gjatë fazës njohëse, por më me intensitet gjatë periudhës së parë të fazës së dytë, do të zhvillojë fushatë informuese tek sektori financiar por edhe tek publiku në tërësi. Kjo fushatë mendohet të realizohet me anë të botimit të një cikli broshurash shpjeguese:

- pasaporta për në Europë;
- përmbledhje e shkurtuar dhe e përshtatur e dokumenteve që kanë krijuar BE;
- përmbledhje e shkurtër e botimeve të BQE-së mbi politikën e vetme monetare të saj;
- shifra dhe fakte mbi vendet e BE-së;
- fjalor me terma të ndryshëm të Europës.

Hap tjetër i rëndësishëm është edhe orientimi në kah të direktivave të BE i të gjithë bazës ligjore dhe rregullative që hartohet dhe rishikohet nga Banka e Shqipërisë.

KAPITULLI IV ZHVILLIMI I FUNKSIONEVE KRYESORE TË BANKËS SË SHQIPËRISË.

IV.1. Mbikëqyrja Bankare.

Banka e Shqipërisë, si shumë banka qendrore në botë, kryen edhe rolin e autoritetit rregullator e mbikëqyrës për sistemin bankar të vendit dhe për atë pjesë të institucioneve financiare jobanka që ajo i gjykon të përshtatshme t'i mbikëqyrë.

Misioni i Bankës së Shqipërisë si autoritet rregullator është:

- të sigurojë qëndrueshmërinë e sistemit bankar dhe të mbrojë interesat e depozituesve dhe të publikut të gjerë;
- të sigurojë një sistem bankar të shëndoshë, aktiviteti i të cilit të jetë transparent dhe i udhëhequr drejt ekonomisë së tregut;
- të rrisë besimin e investuesve dhe të depozituesve nëpërmjet mbështetjes së zhvillimit të industrisë bankare dhe efikasitetit të saj.

Ky mision shpallet publikisht nëpërmjet deklaratës vjetore që miraton Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë.

Objektivi kryesor strategjik është ai i shpallur nga Komiteti i BIS Bazelit për mbikëqyrjen bankare: *“Asnjë njësi të mos i shpëtojë mbikëqyrjes dhe mbikëqyrja të jetë e mjaftueshme”* si dhe respektimi i 25 parimeve bazë të këtij Komiteti për mbikëqyrje bankare të kujdesshme.

Për periudhën afatmesme, funksioni i mbikëqyrjes për sistemin bankar do të jetë pjesë përbërëse e Bankës së Shqipërisë⁴.

IV.1.1 LICENCIMI.

⁴ Për më shumë detaje referoju materialit studimor “Mbikëqyrja jashtë apo brenda Bankës së Shqipërisë”.

Në drejtim të procesit të licencimit, synimet kryesore janë rritja e transparencës së këtij procesi.

Problemi themelor i aspektit të licencimit mbetet shuma e kapitalit minimal të kërkuar për t'u paguar nga një bankë. Nga njëra anë, qëndron detyrimi për të përafuar këtë shumë me standardet e BE-së, nga ana tjetër, qëndron nevoja për të mos krijuar kufizime më të mëdha se mundësia e investitorëve për të çelur bankë dhe nevoja për të patur më shumë banka në Shqipëri.

Aktualisht, shuma e kapitalit minimal të kërkuar për t'u paguar është në nivelin e shumës së kërkuar për ato vende që pritet të lidhin marrëveshjen e asocimit për aderim në BE⁵ dhe e përafërt me shumën mesatare të vendeve të rajonit⁶. Për këtë arsye, si dhe për shkak të ekzistencës së një sistemi bankar me një profil rreziku dhe gamë aktivitetesh të kufizuar, vlerësohet se kjo shumë është e përshtatshme. Rishikimi i saj mund të bëhet gjatë vitit 2004 dhe duke ndjekur ndryshimet që do të kryhen në grupin e vendeve që janë më të përparuara në procesin e integritimit.

Një tjetër element qendror për periudhën afatmesme është politika e licencimit që do të zbatohet: politikë e kujdesshme apo kufizuese. Duke u nisur nga nevoja për të nxitur konkurrencën në sistemin bankar, për të shtrirë rrjetin bankar; për të zgjeruar gamën e produkteve që ofrohen nga sistemi bankar për klientët rezulton se është i arsyeshëm zbatimi i një politike licencuese të kujdesshme duke përdorur elemente përzgjedhëse. Kjo do të thotë që në procesin e licencimit do t'i jepet përparësi miratimit të licencave për ato subjekte që premtojnë nxitje konkurrence; nxitje kreditimi; prezantim produktesh të reja bankare; zgjerim rrjeti bankar; diversifikim të kapitalit nga pikëpamja e origjinës etj. elemente të ngjashme. Për këtë arsye brenda muajit qershor të vitit 2003 do të hartohet politika e licencimit të subjekteve bankare.

Licencimi i degëve të bankave të huaja të BE-së në Shqipëri i nënshtrohet rregullave në mënyrë të njëjtë si edhe licencimi i një banke. Kjo është bërë pasi tregu shqiptar ka nevojë të thithë kapital të huaj në formën e investimit në banka dhe jo thjesht degë, si dhe për të krijuar më shumë mbrojtje për depozituesit shqiptarë. Krijimi i skemës së garantimit të depozitave dhe i autoritetit të luftës për parandalimin e pastrimit të parave, krijojnë bazën për të ecur drejt liberalizimit të këtyre kritereve. Për të realizuar këtë liberalizim vëmendja duhet përqendruar në studimin e hapave që hidhen nga vende që janë më të përparuara në drejtim të integritimit; në ecurinë e degëve të bankave të huaja që aktualisht veprojnë në Shqipëri si dhe presionin për çelje degëbanke apo banka të reja. Ka vend që në vitin 2003 të studjohet mundësia e adoptimit të kritereve të BE me veprim në vitin 2004.

IV.1.2. RREGULLIMI BANKAR.

⁵ Sipas direktivës nr.12 të vitit 2000 të BE-së, shuma e kërkuar e kapitalit është jo më pak se 5 mln euro për vendet që pritet të lidhin marrëveshjet e asocimit. Shih: "Disa konsiderata mbi shumën e kapitalit minimal", material pune, shkurt 2002.

⁶ Mesatarisht kjo shumë për vendet e rajonit është 5.5 milionë dollarë amerikanë. Shih: "Disa konsiderata mbi shumën e kapitalit minimal", material pune, shkurt 2002.

Për periudhën afatmesme, 2003-2005, vëmendja kryesore do të përqendrohet në përafrimin e kuadrit rregullativ me standardet e BE-së, në atë masë që ato mund të përshtaten. Gjithashtu, synohet të reduktohet ritmi i ndryshimit të rregullave të mbikëqyrjes. Që të realizohet kjo, do të rritet periudha e kohës gjatë të cilës përpunohet projekti i rregullores; të zgjerohet baza e diskutimit të projektit të rregullores dhe, pasi të jetë miratuar rregullorja, të mblidhet një numër i mjaftueshëm, i konsiderueshëm rastesh në praktikë përpara se të propozohen ndryshime të mëtejshme. Përbushjes së këtij objekti do t'i shërbejë hartimi i dokumenteve "interpretuese" për rregulloret në fuqi apo për rregulloret e reja që do të miratohen.

Kuadri rregullativ do të plotësohet me rregulla të reja hartimi i të cilave do të lindë nga nevoja e zhvillimit dhe e përsosjes së produkteve bankare. Këtu do të përmenden si më të rëndësishme:

- grupi i rregullave që ka të bëjë me veprimtarinë bankare elektronike (*e-banking*);
- grupi i rregullave që ka të bëjë me produktet derivative si kontratat e së ardhmes, të mundësive etj.;
- grupi i rregullave që ka të bëjë me nxitjen dhe mbrojtjen e konkurrencës në sistemin bankar dhe me moslejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg;
- përgatitja për hyrjen e rekomandimeve dhe të parimeve të Akordit të Ri për Kapitalin të hartuar nga Komiteti i Bazelit për Mbikëqyrjen Bankare. Përveç kësaj, Parlamenti Europian po përgatitet për direktivën "CAD III" për mjaftueshmërinë e kapitalit. Kjo do të kërkojë përshtatjen e rregullores aktuale me Akordin e ri dhe CAD III. Më në detaje do të vihet theksi në lidhjen më të ngushtë të kërkesave për kapital me rreziqet e ndryshme (të kreditit, të tregut dhe operacional) apo në elemente të tjera shtesë. Procesi për përshtatje dhe zbatim, më së paku është i lidhur ngushtësisht me punën e Komitetit të Bazelit, sipas të cilit versioni përfundimtar do të paraqitet në tremujorin e fundit të vitit 2003 dhe periudha e mbetur deri në vitin 2006 do të shërbejë për adoptimet dhe implementimin e duhur;
- hartimi i rregullave për mbrojtjen e klientit që kanë të bëjnë me zbatimin pa diskriminim të tyre dhe me trajtimin e ankesave të klientëve.

IV.1.3. MBIKËQYRJA E JASHTME.

Objektivi kryesor i aktivitetit të mbikëqyrjes nga jashtë është përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë së analizave për të siguruar sinjalizimin e hershëm për problemet që mund të shfaqen në banka të veçanta ose në sistemin bankar në veçanti.

Objektivat për periudhën afatmesme përqendrohen në:

- përsosjen e Sistemit të Paralajmërimit të Hershëm;
- krijimin e një sistemi analize të bazuar në sistemin CAELS, brenda tremujorit të parë të vitit 2003;
- rishikimin e grupbankave, evidentimin e tendencave të treguesve dhe analizimin e konsoliduar mbi bazë grupesh bankash, mbi bazë të sistemit bankar dhe krahasimin me vendet e rajonit;

- analizimin e aktivitetit të subjekteve të tjera jobanka dhe ndjekjen/respektimin e normave të mbikëqyrjes.

IV.1.4. INSPEKTIMET NË VEND - ZEMRA E MBIKËQYRJES BANKARE.

Objektivi më kryesor është rritja e cilësisë së inspektimeve në vend, rritja e efikasitetit në përdorimin e burimeve njerëzore dhe të periudhës së vënë në dispozicion të inspektimit. Kjo realizohet nëpërmjet:

- prezantimit, brenda gjashtëmuajorit të parë të vitit 2003, të procesit të sigurisë së cilësisë;
- ngritjes së një sistemi elektronik të të dhënave, brenda tremujorit të parë të vitit 2003;
- zbatimit të politikës së zhvillimit dhe të trajnimit të inspektorëve gjatë vitit 2003;
- zhvillimit të marrëdhënieve me ekspertët kontabël të pavarur brenda gjashtëmuajorit të parë të vitit 2003;
- ndjekjes së vazhdueshme të procesit të analizës së ecurisë së bankës me qëllim familjarizimin me problemet e bankës dhe identifikimin e tendencave përkeqësuese;
- standardizimit të procesit të inspektimit dhe të dokumentacionit të inspektimit;
- inspektimit të programeve kompjuterike që përdoren nga bankat; integritetit të tyre dhe shkallës së mbrojtjes së tyre (niveleve të sigurisë) nga përdorues të paautorizuar apo nga fshirja e qëllimshme ose jo e informacionit. Ky është një element i rëndësishëm që ndikon dhe në vlerësimin e saktësisë së raportimit në Bankën e Shqipërisë;
- inspektimit të zbatimit të detyrimeve raportuese e publikuese nga bankat tregtare; afishimit të kushteve të punës dhe sidomos zbulimit të plotë të kostos së veprimeve përpara klientit me qëllim që të sigurohet një veprimtari bankare transparente dhe në mbrojtje të klientit;
- hartimit të programeve të dejatuara të inspektimit vjetor, për krejt aktivitetin inspektues; dhe për secilin inspektim në veçanti;
- inspektimit të rasteve për të cilat paraqiten ankesa nga klientët në Bankën e Shqipërisë;
- ndërtimit të procedurave përkatëse për inspektimin e degëve të bankave të huaja brenda vitit 2003.

IV.2. ZHVILLIMI I STATISTIKAVE.

Zhvillimi i statistikave, në tërësi, në vend dhe, në veçanti, në Bankën e Shqipërisë gjatë periudhës 1999-2002 ndihmoi edhe në rritjen e cilësisë së funksionit analizues dhe në marrjen e vendimeve më realiste. Arritje e spikatur në këtë fushë ka qenë anëtarësimi në projektin GDDS dhe fillimi i zbatimit të tij. Shqipëria u zgjodh vend-pilot për këtë projekt dhe Banka e Shqipërisë u zgjodh si koordinatore në këtë proces. Është arritur që të kalohen me sukses disa faza të këtij projekti.

Zgjerimi i spektrit të statistikave të grumbulluara.

- Zgjerimi i bazës së subjekteve që raportojnë me shoqëritë e kursim-kreditit. Gjatë vitit 2003 do të pasurohet raportimi me të dhëna historike për këto njësi.
- Zgjerimi i bazës së subjekteve që raportojnë me institucionet e tjera jobanka, që licencohen ose jo nga Banka e Shqipërisë. Gjatë vitit 2003 mendohet të ketë përfunduar përgatitja e materialit metodik dhe të ketë filluar raportimi nga këto subjekte.

Shkurtimi i afatit të përgatitjes së raportimeve dhe shpërndarjes së tyre.

Ky objektiv mendohet të përmbushet duke reduktuar kohën e raportimit të bankave nëpërmjet përdorimit të raportimit elektronik, duke përshpejtuar procesin e përpunimit dhe të publikimit të informacionit. Ndërsa, përmirësimi i shpërndarjes elektronike të informacionit do të realizohet kryesisht nëpërmjet faqes së internetit.

Përmirësimi i cilësisë së raportimit.

- Rritja e cilësisë së raportimit nga bankat dhe institucionet e tjera, duke përsosur dokumentacionin që lidhet me këto raportime.
- Zhvillimi i teknologjisë së përpunimit të raportimeve nga bankat e nivelit të dytë, me synim aplikimin e raportimit elektronik nga bankat e nivelit të dytë. Kjo synon të rrisë cilësinë e informacionit statistikor.
- Rishikimi i bazës ligjore dhe rregullative me synim lehtësimin e vjeljes së të dhënave, më specifikisht të bilancit të pagesave dhe të institucioneve jobanka që nuk licencohen nga Banka e Shqipërisë.

Rritja dhe zhvillimi i njësisë së vrojtimeve statistikore.

- Rritja e vëllimit të vrojtimeve statistikore në njësinë përkatëse, duke rritur rolin dhe nivelin e kësaj njësie.

- Rritja e bashkëpunimit të institucionit me institucione të tjera si universitete, institute studimore, firma private, që janë të specializuara në mbledhjen e të dhënave ose që kanë baza të krijuara të dhënash.
- Zhvillimi i burimeve njerëzore të njësisë së vrojtimeve, me synim rritjen e profesionalizmit.
- Rritja e frekuencës së kryerjes së vrojtimeve.

Përmirësimi i metodologjisë.

- Në këtë kuadër është duke përfunduar metodika e statistikave monetare dhe financiare, e cila bazohet mbi “Manualin e statistikave monetare dhe financiare, FMN 2001”. Metodika do të jetë një pasqyrim metodik i mënyrës së pasqyrimit të treguesve monetarë dhe financiarë.
- Rishikimi i metodologjive të vlerësimit të të dhënave të ekonomisë reale. Kështu, për bilancin e pagesave mendohet të rishikohen metodologjitë e vlerësimit të treguesve, të cilat nuk merren nga burime zyrtare.

Kontributi në zhvillimin e statistikave në shkallë vendi.

Ky kontribut mendohet të jepet në:

- projekte kombëtare që sensibilizojnë publikun dhe autoritetet shqiptare për rëndësinë e statistikave në përgjithësi;
- projekte konkrete me ndikim të qartë në zhvillimin e nivelit të statistikave, si për aktualitetin ashtu dhe për të ardhmen;
- mbështetjen e institucioneve kryesore statistikore si INSTAT dhe Ministri e Financave në ndërmarrje të përbashkëta të kësaj fushe;
- bashkëpunimin me insitucione akademike dhe shkencore që punojnë në fushën e statistikës, si universitete, akademi, institute studimore etj., për të tërhequr mendimin më të përparuar shkencor në iniciativa institucionale apo kombëtare.

Përgjithësisht do të shikohet me entuziazëm çdo projekt a bashkëpunim që çon në një zhvillim të kulturës kombëtare në këtë fushë.

Njohja, afrimi me Europën.

Ky përbën një nga qëllimet më të rëndësishme të zhvillimeve statistikore. Drejtimet kryesore në gjithë kuadrin institucional janë:

- njohja e standardeve të informacionit të Bashkimit European;
- kualifikimi i stafit lidhur me këto standarde;
- përgatitja e planeve të punës lidhur për adoptimin e këtyre standardeve.

Është menduar që kjo të realizohet në një hark kohor që përfundon në vitin 2004.

Zbatimi i projektit GDDS dhe përgatitja për të zbatuar SDDS.

- Rritja e rolit të grupit të koordinatorëve në disa drejtime si rritja e nivelit të koordinatorëve në të tre institucionet: Banka e Shqipërisë, INSTAT, Ministria e Financave; organizimi i takimeve të rregullta; organizimi i seminareve.
- Forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional për të rritur cilësinë e zbatimit të projektit.

Lidhur me projektin e SDDS-së shtrohen si detyra:

- Ngritja e një grupi specialistësh për studimin e standardeve të SDDS-së, në gjysmën e dytë të vitit 2003.
- Realizimi i një materiali studimor mbi nevojat dhe shkallën e vështirësisë së zbatimit të këtij projekti në Shqipëri, gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2004.
- Zbatimi në trajtë-pilot i metadatave të veçanta për të parë mundësitë dhe vështirësitë konkrete, gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2004.

IV.3. EMETIMI I MONEDHËS.

Përmirësimi i strukturës së monedhës në qarkullim në formë të përshtatshme dhe të pranueshme nga publiku do të jetë objektivi kryesor për tre vitet e ardhshme. Zhvillimi kryesor në strukturë do të jetë rritja e peshës së prerjes 5 mijë lekë, ulje e lehtë në prerjet 1 000 lekë, 500 lekë, 200 lekë dhe 100 lekë, ndërsa për monedhat metalike do të ketë rritje. Struktura e monedhës në qarkullim në vlerë për vitin 2005 parashikohet të jetë:

Tabelë 1. Struktura në %.

Prerjet në lekë	Në %
Kartëmonedha	
5000	30.0
1000	42.5
500	22.1
200	3.1
100	1.3
Monedha metalike	1.0
Totali	100.0

Në lidhje me shtypjet e reja dhe me rishtypjet e kartëmonedhave si dhe zëvendësimin e atyre të dëmtuara, parashikohet:

- Banka e Shqipërisë disponon rezerva në monedhë fizike për nevoja të më shumë se një-dy vjetëve. Për pasojë, nuk rezulton e nevojshme shtypja e kartëmonedhave të reja deri në fund të vitit 2004. Në rast domosdoshmërie, për shtypje kartëmonedhe, do të shihet mundësia e emetimit edhe të një prerjeje me vlerë nominale më të lartë (10 mijë lekë) si dhe mbajtja e një raporti të pranueshëm ndërmjet monedhës në qarkullim dhe gjendjes së rezervave në para fizike.
- Vlerësimi i mundësisë së zëvendësimit pjesor të kartëmonedhave për prerjet e veçanta të emetuara para vitit 1996.

“Marketing-u” i monedhës dhe i kartëmonedhës shqiptare do të jetë aktiviteti që do të tërheqë vëmendje të veçantë në periudhën afatmesme duke:

- zhvilluar emetimet për qëllime numizmatike;
- pasuruar katalogun e monedhave metalike dhe të kartëmonedhave në qarkullim dhe atyre historike;
- hapur muzeun numizmatik.

Ky program synon zhvillimin e mëtejshëm të veprimtarisë në këtë fushë.

Në tërësi, aktiviteti në fushën e emetimit të monedhës do të kërkojë edhe mbështetje logjistike dhe teknologjike me qëllim që të rritet më tej shkalla e përpunimit dhe e kontrollit të kartëmonedhave dhe monedhave metalike; sigurimi në rrugë informatike kontabile (brenda vitit 2003) i treguesve përkatës të nevojshëm për administrimin e parasë si dhe përmirësimi i rregulloreve përkatëse. Për periudhën e përfshirë në këtë plan zhvillimi do të pasurohet

teknologjia ekzistuese e numërimit dhe e përpunimit të parave me synim që ajo të përhapet edhe në degët e Bankës së Shqipërisë.

Së fundi, vëmendje do t'i kushtohet standardizimit të metaleve të çmuara për t'i bërë ato të investueshme.

IV.4. KONTABILITETI.

Objektivi final i sistemit kontabël janë pasqyrat financiare të cilat vlerësohen nga Banka e Shqipërisë jo vetëm për informacionin e rëndësishëm që sigurojnë në procesin e vendimmarrjes, por edhe në rritjen e transparencës për përdoruesit e jashtëm të Bankës të Shqipërisë.

Projekti ATM.

Sistemi ATM do të sigurojë krijimin e një sistemi të integruar kontabël në Bankën e Shqipërisë sipas standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit (SNK) dhe parimeve përgjithësisht të pranura të kontabilitetit (GAAP).

Sistemi i ri i informacionit të Bankës së Shqipërisë përbëhet nga dy module bazë (InFoRex dhe Oracle General Ledger) dhe pesë nënmodule të tjera për veprimtari specifike (Loro, CBR, SLM, Account Payable, Fixed Assets). Sistemi kontabël i integruar do të përmbajë nënsistemet e Librave Ndhmës (*Subsidiary Ledger*) dhe sistemin e Librit të Madh.

Sistemi i ri i integruar kontabël kushtëzon ndërmarrjen në një periudhë afatshkurtër të masave për hartimin e procedurave të kontrollit të brendshëm kontabël.

Hartimi i procedurave të kontrollit të brendshëm në Departamentin e Kontabilitetit dhe Pagesave do të realizohet gjatë gjashtëmujorit të parë 2003.

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2003 do të rishikohet kuadri rregullator kontabël (manuale, metodika dhe udhëzime) për t'u përshtatur me sistemin e ri si dhe me parimet përgjithësisht të pranura të kontabilitetit.

Pasqyrat financiare të Bankës së Shqipërisë.

Bazuar në objektivin e përgjithshëm sipas të cilit Bashkimi Europian ka përshtatur vendimet e nevojshme në forumet e veta dhe ka krijuar organizmat e nevojshëm për zbatimin nga vendet anëtare të SNK-ve duke filluar nga 1 janari i vitit 2005, Banka e Shqipërisë synon t'i paraprijë realizimit të këtij objektivi duke u përqendruar në këto drejtime:

- Njohja e standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit, në përgjithësi, dhe në veçanti ato që lidhen me trajtimin e bankave.
- Rishikimi i formës dhe i përmbajtjes së pasqyrave financiare ekzistuese, llojet dhe informacionet që duhen pasqyruar sipas modeleve të bankave qendrore moderne.

- Njohja me materialet e organizmave ndërkombëtarë mbi transparencën e pasqyrave financiare të bankave qendrore. Vlerësimi i kodit të transparencës dhe përshtatja e kërkesave të tij në pasqyrat financiare të Bankës së Shqipërisë.
- Rishikimi i politikave kontabël të Bankës së Shqipërisë në funksion të përshtatjeve sipas zhvillimeve që do të rezultojnë nga zbatimi i plotë i standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit.
- Hartimi i procedurave të reja kontabile në zbatim të politikave të Bankës së Shqipërisë mbi përdorimin e instrumenteve të reja të tregut të parasë si dhe të atij të kapitaleve.
- Rishikimi i ligjit të Bankës së Shqipërisë në fushën e kontabilitetit si rezultat i detyrimeve të dala nga zbatimi i plotë i standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit si dhe ligjit të ri “Për kontabilitetin”, projekti i të cilit parashikon zbatimin e plotë të standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit prej sistemit bankar.

Për realizimin e objektivave të mësipërm do të punohet sipas këtij grafiku kohor:

- Listimi i të gjitha kërkesave të standardeve për të cilat Banka e Shqipërisë ka devijime gjatë vitit 2003.
- Propozime për ndryshime të ligjit “Për Bankën e Shqipërisë” për të pasqyruar shmangiet nga standardet ndërkombëtare, gjatë tremujorit të parë të vitit 2004.
- Trajnimi dhe specializimi në vazhdimësi i punonjësve të kontabilitetit me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit (SNK).

Buxheti i Bankës së Shqipërisë.

Buxheti është një instrument efektiv për zhvillimin e veprimtarisë, për delegimin e përgjegjësisë si dhe për uljen e kostos. Ai rregullon regjimin e shpenzimeve për zhvillimin normal të veprimtarisë si dhe siguron një mjet të rëndësishëm për kontrollin e shpenzimeve. Buxheti rrit transparencën dhe përgjegjshmërinë në aktivitetin financiar të Bankës së Shqipërisë në kushtet kur ajo gëzon pavarësi financiare.

Objektivat strategjikë të Bankës së Shqipërisë në fushën e buxhetit do të jenë:

- Në fazën e parë do të përfundojë zbatimi i plotë i sistemit të llogaritjes së kostove ndërdepartamentale (qendrat e kostos) si dhe të kostove sipas funksioneve të Bankës. Kjo fazë përfundon në tremujorin e parë të vitit 2003.
- Në fazën e dytë do të përfundojë ndërtimi i buxheteve të veçanta për projektet ndërdepartamentale të një rëndësie të veçantë për Bankën e Shqipërisë. Kjo fazë do të përfundojë në tremujorin tretë të vitit 2003.
- Në fazën e tretë do të realizohet hartimi i politikës së Bankës së Shqipërisë për përpilimin e buxhetit afatmesëm (trevjeçar). Ky objektivi do të realizohet në tremujorin e parë të vitit 2004 në bashkëpunim me Ministrinë e Financave.
- Do të sigurohet transparenca e buxhetit të Bankës së Shqipërisë. Për këtë gjatë gjashtëmujorit të parë vitit 2003:
 - do të hartohet libri i buxhetit të Bankës së Shqipërisë;

- do të përfshihen në pasqyrat financiare të Bankës së Shqipërisë edhe pasqyra e konsoliduar e kostove të shërbimit.

IV.5. SISTEMI I PAGESAVE.

Vizioni i Bankës së Shqipërisë për sistemin e pagesave është realizimi i një sistemi pagesash modern, eficient e të sigurtë. Sistemi i pagesave duhet të sigurojë një platformë dhe aftësi operacionale të përshtatshme për një këmbim të sigurtë dhe eficient vlerash, si dhe t'i krijojë përdoruesit vendas dhe të huaj një besim më të madh në aftësitë dhe në sigurinë e sistemit bankar shqiptar.

Misioni i Bankës së Shqipërisë në fushën e sistemit të pagesave është të luajë rolin e liderit në procesin e reformimit dhe të modernizimit të këtij sistemi.

Objektivat strategjikë të Bankës së Shqipërisë në periudhën 2003-2005 për sistemin e pagesave do të jenë:

- **Plotësimi i Parimeve Themelore** për sistemet e rëndësishme të pagesave, të përcaktuara nga CPSS/BIS⁷ si dhe, i normave e kushteve për përfshirjen në sistemin europian të pagesave TARGET⁸. Lidhur ngushtë me këtë objektiv, Banka e Shqipërisë ka dy objektiva konkretë:
 - **Realizimin e sistemit RTGS** (Real-Time Gross Settlement) për shlyerjen e pagesave ndërbankare me vlerë të madhe, brenda vitit 2003.
 - **Realizimin e sistemit ACH** (Automated Clearing House) për klerimin dhe shlyerjen e pagesave ndërbankare me vlerë të vogël, brenda vitit 2004.

⁷ Committee on Payment and Settlement Systems / Bank for International Settlements.

⁸ Sistemi i Pagesave me vlerë të madhe për EURO.

IV.5.1. PLOTËSIMI I PARIMEVE THEMELORE PËR SISTEMIN E PAGESAVE

Parimet themelore për sistemet e rëndësishme të pagesave janë pranuar nga të gjitha bankat qendrore si standarde për sistemet kombëtare të pagesave. Banka e Shqipërisë synon përmbushjen e tyre brenda periudhës trevjeçare në vazhdim. Për këtë, do të përfundojë një vlerësim i pavarur i sistemit të pagesave në lidhje me zbatimin e 10 Parimeve Themelore, brenda vitit 2004.

Realizimi i sistemeve RTGS dhe ACH do të sjellë edhe plotësimin e kërkesave për një pjesë të parimeve themelore siç janë:

- reduktimi i rreziqeve sistemike;
- finaliteti i shlyerjes brenda datëvalutës;
- siguria dhe besueshmëria;
- shlyerja në sistemet shumëpalëshe.

Për përmbushjen e parimeve të tjera, Banka e Shqipërisë do të përqendrohet në drejtim të:

- përmirësimit të legjislacionit;
- mbikëqyrjes së sistemit të pagesave;
- bashkërendimit dhe transparencës.

Plotësimi i legjislacionit dhe i dokumentacionit të sistemit të pagesave.

Objektiv në këtë drejtim është përafrimi me kuadrin ligjor europian dhe adoptimi i praktikave më të mira ndërkombëtare.

Për arritjen e këtij objekti do të shfrytëzohet asistenca teknike dhe financiare e Bankës Botërore, Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe organizatave të tjera ndërkombëtare. Vendosja e marrëdhënieve dypalëshe me bankat e tjera qendrore do të ndihmojë në këtë drejtim. Orientimi do të jetë drejt vendeve anëtare të Bashkimit Europian dhe vendeve kandidate për të hyrë në BE.

Hapat konkretë për të arritur përputhshmërinë me parimet themelore dhe standardet ndërkombëtare do të jenë:

- Identifikimi i mungesave apo i kundërshtive brenda gjithë kuadrit ligjor që lidhet me sistemin e pagesave, brenda gjashtëmuajorit të parë të vitit 2003.
- Plotësimi i bazës rregullative për anëtarësimin dhe funksionimin në sistemet RTGS e ACH brenda vitit 2004.
- Përgatitja e propozimeve për ndryshimet e mundshme në legjislacionin shqiptar, brenda vitit 2004.

Mbikëqyrja e sistemit.

Në mënyrë që të sigurojë funksionimin normal të sistemit të pagesave, Banka e Shqipërisë synon arritjen e një ekuilibri midis sigurisë së sistemit dhe eficiencës së tij.

Puna e Bankës, në këtë drejtim, do të fokusohet në identifikimin e rreziqeve potenciale në funksionimin e sistemit, në mënyrë që reduktimit dhe administrimit të rreziqeve t'i jepet rëndësia e duhur, si nga operatorët ashtu edhe nga pjesëmarrësit.

Disa prej hapave konkretë që Banka e Shqipërisë ndërmerr në drejtim të eliminimit apo të kontrollit të rreziqeve, realizohen brenda rolit të saj operacional, siç janë:

- Ofrimi i përdorimit të pasiveve të saj në lekë, të cilat konsiderohen si mjete shlyerjeje pa rrezik.
- Ofrimi i lehtësirave kredituese ditore.

Për të ndihmuar në shlyerjen në kohë të pagesave, do të fillojë ofrimi i lehtësirave të kreditimit 'brenda ditës' (*intraday credit*), gjatë vitit 2003.

Realizimi i sistemit të regjistrimit të letrave me vlerë (*book entry*) përbën një kusht për përmbushjen e njërit prej parimeve themelore të sistemeve të pagesave. Banka e Shqipërisë do të synojë realizimin e tij brenda vitit 2005.

Bashkërendimi dhe transparenca.

Banka e Shqipërisë do të përmirësojë rolin e saj bashkërendues dhe katalitik, duke nxitur transparencën dhe duke lehtësuar marrëdhëniet ndërmjet pjesëmarrësve në sistemin e pagesave.

- Drejtimi i Komitetit Kombëtar të Pagesave dhe publikimi i aktivitetit të tij në internet.
- Krijimi i Komitetit të Koordinimit të Projekteve që do të funksionojë pranë Bankës së Shqipërisë me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të bankave, përgjegjës për implementimin e projekteve RTGS e ACH.
- Nxitja e iniciativave private për pagesat elektronike dhe bashkërendimi i përpjekjeve për krijimin e një infrastrukture të përbashkët për to.
- Politika e përcaktimit të çmimit për sistemin RTGS do të bazohet në parimin e 'mbulimit të kostos' dhe do të përcaktohet në bashkëpunim me bankat e nivelit të dytë.
- Grumbullimi vazhdueshëm i të dhënave statistikore periodike për pagesat, me qëllim botimin e Librit të Sistemit Shqiptar të Pagesave sipas standardit 'Red Book', në vitin 2005.

IV.5.2. PËRFUNDIMI I SISTEMIT RTGS.

Në planin afatmesëm të zhvillimit të Bankës së Shqipërisë, do të mbetet objektiv, përfundimi i zbatimit të projektit RTGS.

Banka e Shqipërisë synon përfundimin e implementimit të sistemit RTGS deri në fund të vitit 2003.

Përfundimi me sukses i këtij projekti është kritik për sistemin e pagesave. Këtë projekt Banka e Shqipërisë do ta realizojë me asistencën financiare dhe teknike të Bankës Botërore. Konsulentë të pavarur që kanë marrë pjesë në përcaktimin e kërkesave dhe në dizenjimin e sistemit do të asistojnë edhe në hapat e mëtejshëm të projektit:

- përzgjedhjen e paketës konkrete RTGS-brenda muajit janar 2003;
- procesin e implementimit- deri në dhjetor 2003;
- plotësimin e paketës rregullatore të sistemit, brenda tremujorit të parë të vitit 2004.

IV.5.3. SISTEMI I PAGESAVE NDËRBANKARE ME VLERË TË VOGËL.

Pagesat ndërbankare me vlerë të vogël, janë kryesisht pagesa të inicuar nga klientët e bankave të nivelit të dytë. Banka e Shqipërisë vlerëson se efienca e sistemit të pagesave me vlerë të vogël është me mjaft përfitime për sistemin bankar. Për këtë arsye, ajo ofron jo vetëm shlyerjen e këtyre pagesave, por organizon edhe kleringun e tyre.

Shërbimi i kleringut të pagesave të klientëve është një funksion që mund të dalë nga banka qendrore dhe të administrohet nga një institucion ndërbankar. Transferimi i këtij funksioni tek një institucion privat përbën një synim afatgjatë për t'u realizuar gjatë periudhës 2006-2007.

Duke vlerësuar vështirësitë aktuale në Shqipëri, për shkak të mungesave infrastrukture dhe institucionale, Banka e Shqipërisë do të vazhdojë ta kryejë këtë shërbim edhe për periudhën trevjeçare në vazhdim. Shkëputja e shërbimit të kleringut do të realizohet pasi të përfundojë procesi i automatizimit dhe i standardizimit të tij.

Në funksion të këtij procesi, Banka e Shqipërisë do të realizojë Sistemin e Automatizuar të Kleringut (ACH) për përpunimin e pagesave ndërbankare me vlerë të vogël. Ky sistem do të jetë plotësisht i integruar me sistemin RTGS dhe do të përbëjë një vazhdim logjik të tij.

- Dizenjimi i sistemit do të përfundojë brenda vitit 2003, duke u mbështetur në asistencën financiare dhe teknike të Bankës Botërore.
- Implementimi i sistemit ACH, do të realizohet brenda vitit 2004, duke synuar gjetjen e donatorëve ndërkombëtarë ose me fonde të Bankës së Shqipërisë.

Do të synohet realizimi i një sistemi eficient duke parashikuar mundësinë e shkëputjes nga administrimi i Bankës së Shqipërisë kundrejt një kostoje minimale.

IV.6. ZHVILLIMI I BURIMEVE NJERËZORE.

Zhvillimi i Burimeve Njerëzore në Bankën e Shqipërisë konsiderohet si një funksion i rëndësishëm pasi nëpërmjet tij sigurohen marrëdhënie optimale punëdhënës-punëmarrës dhe rritet rendimenti e cilësia në punë.

Megjithë krijimin e disa elementeve bazë për të zhvilluar këtë funksion, përsëri Banka e Shqipërisë ndeshet me mjaft probleme në këtë fushë gjë që kërkon një angazhim më të madh në periudhën 2003-2005.

IV.6.1. POLITIKA E NXITJES NË PUNË TË PUNONJËSVE.

Objektivi themelor i një politike të tillë synon që të nxisë dëshirën e punonjësve për të punuar dhe për të rritur cilësinë e punës. Elementi bazë i nxitjes në punë është shpërblimi material në formën e pagës dhe të shtesave mbi pagën.

Banka e Shqipërisë, bazuar në pavarësinë e saj institucionale, sidomos financiare, do të përshtasë nivelin e pagave për të siguruar konkurrencë relative me sistemin bankar privat me qëllim që të mbajë në bankë elementet cilësorë. Në këtë drejtim, ka rëndësi të thjeshtohen elementet përbërëse të pagës, të cilat komplikojnë sistemin e llogaritjes; të ruhen më drejt raportet hierarkike në paga dhe paralelisht të krijohet hapësira për diferencim në bazën e specialistëve. Aktualisht, sistemi lejon tre nivele specialistësh: asistent specialisti, specialist dhe kryespecialist, gjë që lejon krijimin e piramidës (karrierës) profesionale dhe shoqërohet me diferencim page. Zgjatja e kulmit të kësaj piramide, duke rritur numrin e kategorive të specialistëve (nga 1 në 5), lejon më shumë mundësi për karrierë profesionale, fleksibilitet në vlerësimin e punës dhe, njëkohësisht, ofron diferencim midis specialistëve, gjë që shkon në favor të nxitjes së konkurrencës në punë.

Shpërblimi monetar është elementi i dytë i nxitjes në punë. Në këtë element mund të gërshetohen politika sociale dhe ajo e vlerësimit të punës.

Nxitja monetare e punonjësit të Bankës është e kufizuar pasi pagat nuk mund të rriten pafundësisht dhe, gjithashtu, edhe shpërblimet monetare. Prandaj, Banka e Shqipërisë do të përdorë edhe format jomonetare të shpërblimit.

IV.6.2. POLITIKA E SPECIALIZIMEVE NË PUNË TË PUNONJËSVE.

Specializimi nëpërmjet punës është një proces i vazhdueshëm i cili synon transmetimin e njohurive për të siguruar vijimësi të punës dhe jo monopolizim të saj. Kjo realizohet duke zbatuar parimin që të paktën dy persona njohin të njëjtin proces; duke organizuar punën në grupe si dhe duke kombinuar punonjës me përvojë më të gjatë me punonjës me përvojë më të shkurtër. Që të ketë efektshmëri ky lloj

specializimi do të kërkojë një angazhim të madh dhe vlerësim të drejtë nga ana e eprorëve të punës që kryhet nga më shumë se një punonjës.

Specializimet në punë mendohet të realizohen në tre forma kryesore:

- në procesin e punës;
- me kurse afatshkurtra specializimi brenda dhe jashtë vendit;
- me kurse afatgjata specializimi brenda dhe jashtë vendit.

Specializimi me kurse afatshkurtra synon që të ofrojë njohuritë bazë mbi veprimtari të ndryshme të bankës qendrore. Këto specializime ofrohen automatikisht për të sapopunësuarit në bankë, të cilët kanë nevojë për të njohur natyrën e bankës qendrore, por edhe kategorive të tjera për të qenë të azhornuar me zhvillimet në fushën ekonomike dhe të bankingut qendror.

Specializimi me kurse afatgjata synon të ofrojë njohuri më të avancuara për veprimtarinë e bankës qendrore.

Specializimet afatgjata do të lidhen me projekte, studime apo përmirësime në procesin e punës, domethënë, me objektiva konkretë. Kjo do të ndihmojë në matjen e efektivitetit të specializimit.

IV.6.3. POLITIKA E PUNËSIMIT.

Procesi i punësimit ndikon drejtpërdrejt në rendimentin dhe cilësinë e punës. Në procesin e punësimit do t'i kushtohet rëndësi:

- aftësive profesionale;
- aftësive komunikuese;
- cilësive personale që ndihmojnë në punësimin jo vetëm të njerëzve të aftë për punë, por edhe të përkushtuar dhe të gatshëm për të respektuar institucionin.

Elementi bazë i përzgjedhjes do të jetë konkursi i cili zhvillohet në dy format klasike: me shkrim dhe nëpërmjet intervistës. Të dyja këto forma lejojnë vlerësimin e të tre elementeve të përshkruara më sipër.

Punësimi ndikon edhe në strukturën e punonjësve të institucionit nga çdo pikëpamje: e moshës, e arsimimit, e seksit etj.. Për këtë arsye do të hartohet politika e punësimit duke:

- analizuar strukturat e punonjësve në Bankë dhe evolucionin e tyre në vite. Në mënyrë të veçantë do të studjohen strukturat e të punësuarve në dy-tre vitet e fundit;
- strukturat që evidentohen, analizohen duke i kombinuar me rezultatet në punë.

Në këtë mënyrë evidentohen grupet me rendiment pune më të mirë; me cilësi pune më të mirë; me propozime vizionare dhe me iniciativë. Krijimi i këtyre modeleve ndihmon për të identifikuar më lehtësisht individët që duam të punësojmë në përputhje me nevojat e Bankës dhe nevojat për të përmirësuar punën në sektorë të caktuar të saj.

IV.7.ORGANIZIMI STRUKTUROR I BANKËS SË SHQIPËRISË.

Zbatimi i detyrave dhe përmbushja e objektivave sigurohet nga puna e punonjësve të Bankës së Shqipërisë, të cilët janë të shpërndarë sipas një strukture organizative, që miratohet nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë.

Struktura aktuale e organizimit të Bankës së Shqipërisë, në tërësi, paraqitet e përshtatshme dhe që mbulon të gjitha funksionet që duhet të kryejë Banka e Shqipërisë. Në përgjithësi, kjo strukturë harmonizohet me struktura të bankave të tjera qendrore. Nuk mund të pritet që kjo strukturë të jetë plotësisht identike me ndonjë strukturë të caktuar pasi:

- nuk ekziston një strukturë uniforme;
- bankat kanë tipare të veçanta dhe kërkesa të veçanta në përputhje me vendin ku ato veprojnë.

Objektivat kryesorë në këtë drejtim specifikohen në:

- rritjen e qëndrueshmërisë organizative të Bankës, duke reduktuar ndryshimet madhore në të, gjë që shton konfuzionin në punë dhe rrit pasigurinë në hartimin dhe në zbatimin e planeve apo në investimin e individëve. Struktura e Bankës së Shqipërisë ka nevojë për ndryshime me karakter përmirësimi kryesisht për t'iu përshtatur detyrave të reja; për të eliminuar strukturat e krijuara nga kushtet e përkohshme; për të lejuar shpërndarjen e kompetencave në marrjen e vendimeve;
- përgatitjen për ndarjen e një pjese të funksioneve të Bankës me qëllim lehtësimin e saj nga funksionet që mund të përftohen prej të tretëve;
- rritjen e numrit të punonjësve të Bankës për të përmirësuar cilësisht punën; për të lejuar specializimin e tyre; për të përballuar një aktivitet më të madh pune në tre vitet e ardhshme si pasojë e detyrave shtesë të parashikuara;
- rritjen e numrit të punonjësve të Bankës duke i dhënë përparësi funksioneve kryesore.

Numri i punonjësve të bankës qendrore synohet të jetë një numër optimal që të sigurojë kryerjen e funksioneve të saj me cilësi dhe pa rënduar koston.

Për periudhën afatmesme tendenca do të jetë rritja e numrit të punonjësve të bankës qendrore, kjo për disa arsye:

- po shtohen detyrat që ka Banka e Shqipërisë ose po zgjerohen ato;
- po rritet numri i subjekteve që Banka e Shqipërisë licencon dhe mbikëqyr;
- po theksohet specializimi në punë;
- është ende në proces informatizimi dhe automatizimi i punës në Bankë, përfundimi i të cilëve do të ndikonte në reduktimin e numrit të punonjësve;
- kryen ende funksione të cilat në periudhë afatmesme do t'i shkëputen.

Rritja e numrit të punonjësve të Bankës së Shqipërisë është në përputhje me tendencën e përgjithshme të bankave qendrore të vërejtura në botë, e cila shkon sipas një kurbe të fortë rritëse në vitet e para të veprimtarisë, arrin pikun, dhe më pas reduktohet nga reduktimi i funksioneve dhe rritja e përpjekjeve për ekonomizimin e kostove. Ky zhvillim i plotë kërkon një cikël kohor prej 15-20 vjetësh. Numri i punonjësve të Bankës së Shqipërisë është ende në kurbën rritëse dhe nuk ka arritur

PLANI I ZHVILLIMIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË, 2003-2005.

pikun. Në periudhën afatmesme pritet që ky numër të rritet në nivelin rreth 400 punonjës.

KAPITULLI V ZHVILLIMI I FUNKSIONEVE MBËSHTETËSE TË BANKËS SË SHQIPËRISË.

V.1. Zhvillimi i Teknologjisë së Informacionit.

Banka, është si një institucion që ofron shërbime e produkte për klientët e saj, ashtu i orientuar drejt kërkimit, grumbullimit, analizës dhe shpërndarjes të informacionit. Nga njëra anë, ajo ka si qëllim rritjen e shkallës së komunikimit dhe informimit tek / nga ambjenti i jashtëm, zhvillimin e transparencës së brendshme dhe të jashtme ndërsa, nga ana tjetër, ajo kërkon të ruajë dhe të mbrojë me fanatizëm konfidencialitetin dhe besueshmërinë e një pjese të informacionit dhe të aktivitetit të saj. Në këtë këndvështrim, është i nevojshëm, gërshetimi i kujdesshëm i dy politikave dhe procedurave të kundërta, si ajo e hapjes dhe transparencës ashtu dhe ajo e mbrojtjes dhe ruajtjes.

Banka është një institucion qendror dhe pa qëllim fitimi, me detyrat e saj kryesore të përcaktuara në ligj. Pozicioni qendror e vendos atë larg konkurrencës direkte, por megjithatë nevojat e saj të zhvillimit kanë në bazë realizimin me eficiencë dhe efektivitet të detyrave ligjore, mbështetjen dhe mundësimin e vazhdueshëm të rritjes së sistemit bankar në Shqipëri. Në këtë kontekst, Banka kërkon të mbërrijë visionin e mëposhtëm në fushën e TI:

“TI do të mundësojë komunikimin e personelit, të klientëve dhe të publikut të Bankës, në çdo kohë, me mjetet dhe informacionet e brendshme në mënyrë eficiente, të besueshme e të sigurtë, duke zbutur diferencat midis komunikimit të brendshëm dhe të jashtëm.”

Për arritjen e vizionit të parashikuar në fushën e TI, Banka identifikon katër objektiva kryesorë:

- **Përmirësimi/zhvillimi i njohurive dhe administrimi i informacionit:** Banka është zotëruese tashmë e një numri të madh informacionesh (dokumente, të dhëna ekonomike, punime të ndryshme, të dhëna operationale e që lidhen me realizimin e aktivitetit ditor) të cilat nga një anë janë rezultat i një aktiviteti paraprak dhe, nga ana tjetër, përbëjnë bazë për analiza apo përpunime të mëtejshme. Nevoja në rritje për informacion të shpejtë, të besueshëm kërkon nga njëra anë përshpejtimin e procesit të shpërndarjes dhe kërkimit të informacionit dhe, nga ana tjetër, zhvillimin e njohurive të burimeve njerëzore. Për këtë, banka do të punojë si për rishikimin dhe përmirësimin e mënyrës së deritanishme të komunikimit, ashtu edhe të shpërndarjes me qëllim automatizimin e vazhdueshëm të tij.
- **Rritja e shkallës së sigurisë së informacionit, e infrastukturës mbështetëse si dhe e procesit të administrimit të saj:** Banka është pronare e një sërë sistemesh informacioni me rëndësi kombëtare dhe mosfunktionimi i rregullt apo i pjesshëm i tyre është me pasoja jo vetëm për sistemin bankar, por dhe më gjerë. Rritja e shpejtë e sistemeve të informacionit në Bankë, si dhe eksperiencia e pakët në

drejtim të administrimit të sigurisë përbëjnë një rrezik dhe si rrjedhim administrimi i këtij rreziku përbën një ndër prioritetet e zhvillimit të Bankës. Ruajtja e konfidencialitetit mbi këto informacione nisur dhe nga nevoja e Bankës për hapje është gjithashtu një sfidë. Në TI, përgjithësisht nisur nga zhvillimet e shpejta, mbrojtja e tyre nuk mund të konsiderohet si statike ajo duhet të jetë e azhurnuar në ç’do kohë dhe për më tepër të ketë një sjellje parandaluese.

- **Përmirësimi dhe zhvillimi operacional:** Rritja e shkallës së eficiencës dhe standardizimit. Kjo do të realizohet nëpërmjet rritjes dhe përmirësimit të vazhdueshëm të aktivitetit administrativ dhe operacional të Bankës e që lidhet në mënyrë të veçantë me (1) futjen e sistemeve të reja në një sërë aktiviteteve operacionale, (2) përmirësimin si dhe zëvendësimin e sistemeve ekzistuese, (3) krijimin e zyrës së “Help Desk” për përmirësimin e shkallës së suportit, në kohë dhe cilësi të sistemeve administrative dhe operacionale në Bankë. Sistemet e reja do të (1) zgjerojnë fushën e shtrirjes së TI në operacionet e Bankës, (2) realizojnë zëvendësimin dhe integrimin midis funksioneve të mbuluara nga sisteme të veçanta, të cilat shpeshherë dublojnë aktivitetet e njëri – tjetrit, (3) rrisin shkallën e automatizimit të operacioneve duke zvogluar rrezikun e gabimeve si dhe duke rritur shkallën e orientimit të punonjësve rreth detyrave kryesore të tyre.
- **Forcimi dhe përmirësimi i komunikimit dhe i administrimit teknik:** Qëllimi i këtij programi është rritja dhe përmirësimi i vazhdueshëm i infrastrukturës teknike të Bankës. Për të realizuar një zhvillim të përgjithshëm të TI në Bankë, kjo infrastrukturë duhet të zhvillohet dhe të mbështetet në terma sigurie, qëndrueshmërie, besueshmërie, në universalitetin e përdorimit, fleksibilitetin e përshtatjes për futjen e zhvillimeve të reja në fushën e TI.

Zbatimi i plotë i strategjisë së zhvillimit të teknologjisë së informacionit, do të sjellë përmirësime në aktivitetin e brendshëm të punës në Bankë, në shërbimet që ofron ajo te klientët e saj (sistemin bankar shqiptar dhe më gjerë). Përparësitë mund të ndahen në dy grupe kryesore: përmirësimin e efektivitetit dhe rritjen e eficiencës së operacioneve dhe aktiviteteve.

V.2. Funkzioni ligjor.

Banka e Shqipërisë në gjithë aktivitetin e saj, mbështetet në një bazë ligjore dhe rregullative, e cila mund të konsiderohet përgjithësisht e plotësuar dhe e krahasueshme me atë të bankave qendrore homologe në botë. Kuadri ligjor dhe rregullativ në Bankën e Shqipërisë është hartuar në përputhje me vetë zhvillimet që ka pësuar sistemi bankar dhe financiar në Shqipëri, si dhe gjithë zhvillimi në tërësi i kuadrit ligjor.

Në periudhën afatmesme, duke patur parasysh nevojën për të mbështetur me ligje e rregulla zhvillimet e sistemit bankar dhe të Bankës së Shqipërisë, do të synohet:

- Zgjerimi dhe plotësimi i paketës ligjore, gjë e cila arrihet me hartimin dhe përpilimin e ligjeve apo të akteve juridike të reja.
- Përmirësimi i bazës ligjore dhe rregullative me synim vendosjen mbi bazën e standardeve ndërkombëtare dhe harmonizimin me ligjet dhe me rregullat përkatëse të BE.
- Forcimi i elementit interpretues për të unifikuar qëndrimet në lidhje me ligjet dhe rregullat e ndryshme dhe zbatimin e tyre.

Këto synime do të realizohen duke:

- Përcaktuar, gjatë vitit 2003 e në vazhdim, programe të qarta në fushën e përafrimit të legjislacionit të Bankës së Shqipërisë me atë të Bankës Qendrore Europiane mbështetur edhe në parimet e Acqui Communautaire⁹.
- Miratuar në muajin shkurt 2003 Pjesën e Veçantë të Kushteve të Përgjithshme të Punës së Bankës së Shqipërisë.
- Hartuar në muajin prill 2003 projektin mbi “Kodin e etikës së anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë”.
- Rishikuar gjatë muajit maj 2003 aktet nënligjore në fushën e klasifikimit të informacionit sekret në Bankën e Shqipërisë.
- Rishikuar gjatë muajit shtator 2003 kuadrin rregullativ në fushën e transparencës së Bankës së Shqipërisë.

Në objektivat afatmesëm në fushën e përmirësimit të kuadrit ligjor dhe rregullativ në Bankën e Shqipërisë përmendim:

- Rishikimi i ligjit “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, duke u mbështetur edhe në vlerësimet e bëra nga Banka Botërore për këtë ligj, brenda muajit prill 2004.
- Hartimi i projektligjit “Për regjimin dhe tregun e këmbimeve valutore”, brenda muajit qershor 2004.
- Krijimi i bazës rregullatore në fushën e krijimit të zyrës së informacionit të kredive dhe transfertave, brenda janarit të vitit 2005.

⁹ Baza e plotë juridike rregullative e Komunitetit Europian.

Përveç projekteve të mësipërme, ku Banka e Shqipërisë do të luajë rolin e një institucioni “inisiator” për hartimin e projektligjeve, vetë zhvillimi ekonomik i vendit, sidomos i sektorit financiar, kërkon që Banka e Shqipërisë të jetë pjesëmarrëse edhe në proceset e hartimeve të ligjeve të ndryshme. Kështu, Banka e Shqipërisë do të jetë pjesëmarrëse në procesin e plotësimeve dhe ndryshimeve të:

- Kodit Civil në Republikën e Shqipërisë, të iniciuara nga Ministria e Drejtësisë, sidomos në pjesën që lidhet direkt me bankat.
- Ndryshimeve, gjatë vitit 2003, të ligjit “Për parandalimin e pastrimit të parave”¹⁰.
- Në procesin e plotësimeve dhe përmirësimeve të sistemit ligjor të tatim-taksave për pjesën që lidhet me sistemin financiar apo në përgjithësi të fushës financiare, që dërgohet për mendim apo që kërkohet bashkëpunim.
- Në procesin e ndryshimeve të mundshme të ligjit “Për kontabilitetin”.

V.3. MBROJTJA E BANKËS.

Zhvillimi normal i aktivitetit të bankës qendrore arrihet jo vetëm nëpërmjet ushtrimit të funksioneve bazë por edhe nëpërmjet krijimit të një ambjenti të sigurt e të mbrojtur pune.

Për periudhën afatmesme Banka do të vijojë të përballojë shpenzimet e eskortës së policisë që përdoret për kryerjen e operacioneve monetare. Situata politike dhe e rendit, shkalla e kriminalitetit në vend kushtëzojnë që krejt sistemi i godinave dhe i ambjenteve të Bankës së Shqipërisë të vijojnë të mbrohen nga forcat e policisë së objekteve. Banka e Shqipërisë, brenda gjashtëmujorit të parë të vitit 2003, të kërkojë që shpenzimet për kryerjen e këtij shërbimi të përballohen nga buxheti i shtetit.

Po kështu, për tre vitet e ardhshme do të përgatitet edhe studimi i krijimit të policisë bankare, si një trupë e specializuar për marrjen nën mbrojtje të institucioneve financiare të vendit.

Disiplinimi më i mirë i regjimit të lëvizjeve ndihmon në rritjen e shkallës së sigurisë. Godina dhe ambjentet e Bankës ndahen në zona të cilat klasifikohen në zona me qarkullim të lirë (ku lejohet të hyjë publiku); zona me qarkullim të kufizuar dhe zonat e sigurisë.

Në përputhje me ndarjen e zonave në godinën qendrore do të përmirësohet sistemi i qarkullimit brenda gjysmës së parë të vitit 2003 dhe sistemi i mbikëqyrjes brenda vitit 2003.

Brenda vitit 2003 do të përshtatet i njëjti sistem klasifikimi i godinës kryesore edhe në godinat e degëve në rrethe. Në degët, godinat e të cilave janë

¹⁰ Këto ndryshime janë përgatitur nga Drejtoria e Bashkërendimit të Luftës kundër Pastrimit të Parave, por Banka e Shqipërisë ka qenë pjesëmarrëse aktive në hartimin e këtyre ndryshimeve.

rikonstruktuar, do të instalohet sistemi i kontrollit të hyrjeve.

Brenda tremujorit të parë të vitit 2003 do të rishikohet rregullorja që disiplinon qarkullimin e personave jopunonjës në godinën e Bankës, me qëllim që lëvizja e tyre në godinë të jetë më e siguar.

V.4. PËRMIRËSIMI I KUSHTEVE TË PUNËS NË BANKË.

Kushtet dhe ambjentet e punës së institucionit duhet të jenë të tilla që të ofrojnë një situatë normale që lejojnë punonjësit të punojnë të qetë dhe në komoditet. Krijimi i ambjenteve komode ka rëndësi pasi rrit përqendrimin dhe rendimentin në punë. Detyra të rëndësishme në drejtim të përmirësimit të ambjenteve të punës për t'u zgjidhur brenda periudhës 2003-2005, shtrohen:

- rikonstrukcioni i godinës ekzistuese;
- shtimi i hapësirave të punës për të vënë në dispozicion të punonjësit sipërfaqe të nevojshme pune si dhe ambjente shtesë për aktivitete të tjera. Kjo mund të sigurohet me ndërtimin e godinës së re të Bankës së Shqipërisë. Për godinën e re duhet të paraqiten kërkesat maksimale të ambjenteve dhe hapësirë e konsiderueshme për një post pune, për 400 punonjës si dhe për aktivitete të tjera;
- Banka e Shqipërisë mund të studjojë (brenda vitit 2003) mundësinë e kthimit në një institucion mbrojtës të kulturës së vendit. Për këtë qëllim mund të përcaktohen çdo vit fonde të veçanta. Synimi është të mbrohet historia e kulturës shqiptare. Për përzgjedhjen e tyre krijohet një komision i posaçëm me artistë dhe kritikë arti të njohur dhe nën kujdesin e Ministrisë së Kulturës;
- modernizimi i arkivës dhe ruajtja e saj në formë elektronike për ta bërë më të përshtatshme edhe për përdorim.

V.5. FORCIMI I AFTËSIVE TË KONTROLLIT DHE TË AUDITIT TË BRENDSHËM.

Departamenti i Kontrollit të Brendshëm mund të luajë një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punëve të institucionit, duke ndihmuar për një administrim efikas, sidomos në identifikimin dhe ndreqjen e problemeve të institucionit.

Objektivat afatmesëm të zhvillimit të departamentit do të synojnë në:

1. Kryerjen e funksionit të auditit të brendshëm sipas standardeve ndërkombëtare. Për arritjen e këtij objektivit duhet që:

- Auditet të kryhen në përputhje me standardet e praktikës profesionale të auditit të brendshëm.
- Sjelljet e auditorëve të jenë në përputhje me kodin e etikës së auditorëve të brendshëm.
- Të mbahet lidhje e vazhdueshme me organizatat e auditorëve të brendshëm, për të njohur ndryshimet dhe adoptimet përkatëse të standardeve.

2. Transformimin e karakterit të funksionit të auditit të brendshëm nga prapaveprues në parandalues. Për arritjen e këtij objektivi duhet:

■ Të bëhet rivlerësimi i rrezikut të kontrollit për të gjitha funksionet e bankës, në përshtatje me kushtet e reja të punës, përdorimit të sistemeve të reja të kontabilitetit dhe të rekomandimeve të dhëna për përmirësimin e të metave të konstatuara nga auditori i jashtëm, organizmat ndërkombëtarë dhe Kontrolli i Lartë i Shtetit. Të analizohen të metat e konstatuara në veprimtarinë e sektorëve të ndryshëm të bankës me qëllim moslejimin e përsëritjes së tyre.

(brenda vitit 2003)

■ Të bëhet paraqitja e vendosjes së sistemit të kontrollit të brendshëm, sipas funksioneve të veçanta të bankës si dhe mbikëqyrja e vazhdueshme e ndryshimeve që ndodhin në të, me qëllim të uljes së rrezikut të ndodhjes së gabimeve ose të rritjes së mundësisë për zbulimin e shpejtë të tyre.

(brenda vitit 2003)

■ Të përgatiten kushtet për instalime të programeve bashkëkohore të auditit, në përputhje me llojet, me strukturën dhe me veprimtarinë operacionale të bankës.

(brenda vitit 2004)

■ Të krijohet historiku i vlerësimit të rrezikut të funksioneve sipas auditeve të kryera, duke realizuar që mbi baza rotacionale t'i jepet përparësi fushës me rrezik më të lartë, duke synuar mbajtjen e rreziqeve në nivele të pranueshme.

■ Të plotësohen procedurat operative për dokumentimin e punës së kryer, në përshtatje me standardet ndërkombëtare dhe me legjislacionin e vendit.

3. Rritjen e efektivitetit dhe të eficiencës së veprimtarisë së Departamentit të Kontrollit. Për të arritur këtë duhet bërë:

■ Njohja e teknikave bashkëkohore në vlerësimin e efektivitetit dhe të eficiencës në veprimet operacionale dhe administrative për të dhënë rekomandime të përshtatshme për përmirësimin e treguesve në të ardhmen.

(në vazhdimësi)

■ Ngritja e vazhdueshme e nivelit të punonjësve të ngarkuar me detyrat e kontrollit, duke u njohur jo vetëm me progreset e arritura nga bankat e tjera qendrore, por edhe nëpërmjet trainimeve përkatëse.

4. Rritjen e transparencës dhe të pavarësisë së Departamentit të Kontrollit. Për të arritur këtë duhet:

■ Të krijohen lidhje me Kuvendin e Shqipërisë për dërgimin e raporteve periodike dhe atyre vjetore lidhur me kontrollet e ushtruara në Bankën e Shqipërisë, gjetjet dhe rekomandimet e dhëna.

(brenda vitit 2003)

■ Të informohet vazhdimisht dhe të raportohen në Këshillin Mbikëqyrës

PLANI I ZHVILLIMIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË, 2003-2005.

rezultatet e kontrolleve të ushtruara në strukturat e Bankës, rekomandimet e dhëna dhe ndjekja e zbatimit të tyre, çdo tremujor.

■ Të njihen njësitë në bankë me konkluzione të raporteve të kontrollit, të ushtruara në funksione të veçanta të saj.

(tremujori i parë i vitit 2003 e në vazhdim)

■ Të studiohet riorganizimi i strukturës së kontrollit të brendshëm me synim krijimin e Komitetit të Kontrollit, duke propozuar amendamentet përkatëse në ligjin “Për Bankën e Shqipërisë”. Realizimi i tyre bëhet i mundur pasi në Kuvendin e Shqipërisë të miratohen ligjet e veçanta për kontrollin e brendshëm dhe për auditimin, të cilat aktualisht janë në fazën e diskutimit.

(brenda vitit 2005)

KAPITULLI VI ÇËSHTJE TË TJERA.

VI.1. Marrëdhëniet e Bankës së Shqipërisë me të tretët.

Marrëdhëniet e Bankës së Shqipërisë me institucione të tjera lejojnë që ajo të integrohet me ambjentin rrethues, të përçojë te ky ambjent rezultatet e punës së saj si dhe të sigurojë përkrahjen dhe ndihmën e nevojshme për të rritur cilësinë e punës së saj.

Objektivi i Bankës së Shqipërisë është zgjerimi i këtyre marrëdhënieve me institucionet e huaja e të vendit si dhe vënia e tyre mbi një bazë më harmonike me qëllim të mospërplasjes së përvojave.

Për këtë, do të studjohen tiparet e çdo banke qendrore apo institucioni tjetër që ofron asistencë si dhe do të shkëputen ato çështje nga të cilat mund të përfitojë Banka e Shqipërisë. Mbi bazë të këtij studimi, që do të kryhet gjatë gjysmës së parë të vitit 2003, do të ndërtohet deri në fund të vitit 2003 harta e marrëdhënieve. Në këtë përpjekje do të kenë vend të rëndësishëm ambasadat përkatëse të huaja në Shqipëri.

Banka e Shqipërisë në mënyrë të vazhdueshme do të kërkojë rritjen e bashkëpunimit me institucionet brenda vendit për shkëmbimin e informacionit dhe diskutimin e programeve e projekteve me rëndësi kombëtare në fushën e ekonomisë dhe të financave. Rëndësi merr rritja e bashkëpunimit me autoritetet e tjera mbikëqyrëse për të forcuar disiplinën në tregun financiar. Në këtë kuadër, më prioritare për Bankën e Shqipërisë konsiderohen marrëdhëniet me Ministrinë e Financave dhe me INSTAT.

VI.2. Përfundim.

Plani trevjeçar i zhvillimit institucional të Bankës së Shqipërisë do të:

- pasqyrohet në mënyrë më të detajuar në planet vjetore të departamenteve dhe të Këshillit Mbikëqyrës;
- raportohet në muajin qershor të çdo viti tek Guvernatori realizimi i hapave përkatës dhe do të parashtrihen nevojat për ndryshimet e nevojshme;
- raportohet në muajin dhjetor të çdo viti në Këshill Mbikëqyrës ecuria e zbatimit të tij dhe propozimet për rishikimet përkatëse;
- respektohet maksimalisht për të kufizuar devijimet prej tij dhe në rastet kur kjo paraqitet e domosdoshme do të bëhen korrektime përkatëse me qëllim që zbatimi i planit të vijë natyrshëm dhe jo duke krijuar ngarkesë shtesë që mund të çojë në ulje të cilësisë së zbatimit të tij;
- shoqërohet me zbatim uniform prej krejt strukturave të Bankës.